



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Tokën Bujqësore.
2. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Prishtinë 2021

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Përmbajtja	
Hyrje	3
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	7
Madhësia e fermës	16
Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shoqërore në Republikën e Shqipërisë	65
Në Republikën e Shqipërisë - Privatizimi i tokës bujqësore është realizuar në	65
bazë të Ligjit Nr. 7501, Për Tokën, datë 19.7.1991. Toka Bujqësore në pronësi shtetërore menaxhohet në harmoni me Ligjin Nr.8318 datë 1.04.1998 “Për dhënie me qira të tokës bujqësore pyjore, të livadheve dhe kullosave që janë pasuri shtetërore”	65
Kapitulli 2: Objektivat	74
Kapitulli 3: Opsionet	76
3.1: Opsioni asnjë ndryshim	76
3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit	77
3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument]	78
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	82
Ndikimi në të drejtat themelore	85
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	85
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	87
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	89
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	89
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet	98
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	99
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	106
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik	107
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	109
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	112
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore	114

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Hyrje

Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Tokën Bujqësore
Ministria bartëse	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje Divizioni i Shfrytëzimit të Tokës Bujqësore
Personi kontaktues	Idriz Gashi 038/ 200 38 618 ; 044/ 128 603
Plani Strategjik dhe Operacional	Qëllimi Strategjik 2 –Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokave bujqësore, pyjeve dhe ujit për ujijtje); Objektivi operacional 2.1 – Përmirësimi i politikave për menaxhimin dhe ruajtjen e tokës bujqësore; Aktiviteti 2.1.1 – Hartimi i Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore
Prioriteti strategjik	- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural 2.10.3 Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokës bujqësore, pyjeve dhe ujit për ujijtje) - Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 Shtylla I - Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit; Masa 13- Forcimi i shtetit të drejtave pronësore; Aktiviteti 2 - Promovimi i tregut të tokës që mundëson rritje ekonomike, duke përfshirë lehtësimin e konsolidimit të tokave bujqësore, si dhe hartimin dhe miratimin e planeve zhvillimore komunale dhe hartave zonale. Shtylla II – Industritë konkurruese, Masa 20 – Rregullimi i tokave bujqësore: Aktiviteti 1 – Përgatitja dhe financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural; Aktiviteti 2 – Ndërmarrja e reformave strukturore (me theks në masa ligjore dhe institucionale) me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore. Aktiviteti 3 – Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësor, si dhe do të avancohet projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS).

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

	Aktiviteti 4 – Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal - qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër. Programi për Reforma në Ekonomi 2021-2023 Masa e reformës #3: Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë 1. Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore me fokus në produkte me vlerë të shtuar (MBPZHR) Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2021 (PKZMSA) 3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural; 3.11.3 Masat zbatuese- Korniza e Politikave- Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore. Objektivi strategjik: Menaxhimi i tokës bujqësore si një resurs natyror dhe e mirë e përgjithshme duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e saj për prodhimtarinë bujqësore për të siguruar prosperitet ekonomik të vendit. Objektivat specifike: - Përmirësimi i menaxhimit të drejtë dhe të qëndrueshëm të tokave bujqësore dhe kullotave në pronësi shoqërore; - Administrimi dhe Menaxhimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i tokave bujqësore që menaxhohen nga Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) në Pejë; - Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, ndotja, erozioni, degradimi, etj; - Qiradhënia e Tokës Bujqësore.
Grupi punues	Me Vendimin Nr.472, Ref.ZSP 622/20 i datës 06.07.2020, zv.Sekretari i Përgjithshëm i MBPZhR-së emëron Grupin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore: Isuf Cikaqi-Kryesues, Idriz Gashi, Marjan Karrica, Feti Muriqi, Fatmire Mirena, Isah Rudaku, Kreshnike Arifi, Merita Ramaxhiku, Albulena Maloku, ZKM/SKQ -Ekrem Ahmeti, MMPH- Servet Spahiu, GIZ -Vjollca Limani .
Informata shtesë	Në vitin 2011 Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Tokën

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

	Bujqësore Nr.02/L-26. Komisioni pati përgatitur një Raport me rekomandime, të cilin e ka paraqitur në Kuvend. Një pjesë e këtyre rekomandimeve nuk është më relevante për këtë Koncept Dokument. Rekomandimet relevante të këtij raporti janë të përfshira si më poshtë: - Rekomandimi Nr.3 - komunat t'i nxjerrin planet zhvillimore komunale duke përfshirë planifikimin hapësiror rural dhe zonimin e ndërtimit në fshatra (Harta Zonale), MMPH dhe MBPZhR të ndihmojnë komunat në përgatitjen e tyre dhe aftësimin e zyrtarëve komunale për hartimin e këtyre planeve; - Rekomandimi Nr.4 - Komuna para aprovimit të planeve zhvillimore të kërkojë pëlqimin nga MBPZhR sipas Ligjit, në raste të mos kërkit të pëlqimit të njoftojë Qeverinë e Kosovës, si dhe të inicojë procedurat për mos zbatim të Ligjit; - Rekomandimi Nr.6 - të themelohet Fondi për tokën bujqësore; - Rekomandimi Nr. 7 - Gjykatat të iu japin prioritetet lëndëve që kanë të bëjnë me tokën bujqësore; - Rekomandimi Nr. 8 - Ministria bashkë me komunat të angazhohen për organizimin e fushatave sensibilizuese për mbrojtjen e tokës bujqësore; - Rekomandimi Nr.9 - MBPZhR ta këtë një përfaqësues anëtar të bordit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian i vitit 2020 për Bujqësinë thekson : - Kosova ka një nivel të përgatitjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në përgjithësi është bërë progres i limituar, e veçanërisht në zbatimin e programeve vjetore të zhvillimit agro-rural dhe vlerësimin e tij, por progresi në konsolidimin e tokës dhe mbrojtjen e tokës është i pamjaftueshëm. Meqenëse jo të gjitha rekomandimet e vitit 2019 janë kryer, në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet të: → Kryejë një vlerësim cilësor të efektivitetit të masave mbështetëse të parashikuara në programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural; → Miratojë ligjin për organizatat e përbashkëta të tregut; → Marrë masa urgjente, efektive për të ndaluar humbjen e tokës bujqësore dhe të zbatojë legjislacionin për planifikimin hapësinor.
--	--

	Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian i vitit 2019 për Bujqësinë (pika 6.17) thekson: “Kosova ka një nivel të përgatitjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Progres i kufizuar është bërë në përmirësimin e zbatimit të programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti: → Të përmirësojë vlerësimin dhe monitorimin e granteve dhe pagesave direkte në kuadër të programit; → Rishikimin dhe përditësimin e programit në mënyrë që investimet në sektor të jenë më efikase; → Të marrin masa urgjente dhe efektive për të ndaluar humbjen e tokës bujqësore dhe për të zbatuar legjislacionin për planifikimin hapësinor. Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian i vitit 2018 për Bujqësinë thekson: “Ndryshimet ligjore në shfrytëzimin e tokës bujqësore vazhdojnë të ndikojnë në disponueshmërinë edhe ashtu të kufizuar të tokës së punueshme dhe produktivitetin e fermave. Nuk ka informata se sa tokë bujqësore humb Kosova në baza vjetore, si dhe nuk ka ndonjë strategji apo plan veprimi për të adresuar këtë çështje. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të ndërmarë masa urgjente për të ndaluar humbjet e mëtutjeshme të tokës bujqësore, si dhe të zbatojë legjislacionin që rregullon planifikimin hapësinor”.

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Administrimi dhe menaxhimi efikas i tokës bujqesore, mbrojtja e tokës bujqesore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane dhe degradimi i mëtejshëm, mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i tokës bujqesore si një resurs natyror dhe e mirë e përgjithshme duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Gjatë viteve të fundit është arritur një përparim i madh në këtë drejtim, megjithatë degradimi i tokës bujqesore, zgjerimi i pa kontrolluar urban, ndotja mjedisore dhe dëmtimet e burimeve natyrore janë problemet që duhet adresuar në të ardhmen. Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është të mbyllë epokën e ndërtimeve pa leje, të krijoj standarde në planifikimin hapësinor (të hapësirave urbane dhe rurale) dhe të krijojë një mjedis institucional për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, që do të arrihet nëpërmjet një shkrirjeje të politikave specifike sektoriale në një trajtim të integruar. Trajtimi i integruar kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore në mënyrë të përfunduar reciprokisht.

Koncept Dokumenti ka për qëllim të adresojë çështjet, të cilat kanë penguar në menaxhimin e drejtë dhe të qëndrueshëm të tokës bujqesore për shfrytëzim për prodhimtari bujqesore. Që nga miratimi i Ligjit për Tokën Bujqesore është vërejtur zbatimi dhe mbikëqyrja jo adekuate nga organet e autorizuar ligjore, por edhe mangësitë në kornizën ligjore në fuqi që e rregullojnë çështjen e administrimit, menaxhimit, planifikimin e përdorimit-shfrytëzimit, mbrojtjes dhe qiradhënies. Sfidat kryesore për shfrytëzimin e tokës bujqesore lidhen me:

- Definimin jo të qartë të kompetencave të nivelit qendror dhe lokal lidhur me:
 - o Dhënien e pëlqimit nga MBPZhR-ja në draft Planin Zhvillimor Komunal para aprovimit të këtij Plani në komuna;
 - o Dhënien e pëlqimit nga MBPZhR-ja për ndërrim të destinimit të tokës bujqesore-pyjore në tokë për qëllime jo bujqesore-pyjore, për kategoritë e klasës I-IV;
 - o Mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit përmes inspektorëve të nivelit qendror dhe zbatimit të Ligjit nga inspektorët e autorizuar komunal;
- Administrimi dhe menaxhimi jo i drejtë i tokës bujqesore dhe të kullotave në pronësi shoqërore;
- Administrimi dhe Menaxhimi i tokave bujqesore që aktualisht menaxhohen nga Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) në Pejë;
- Humbja e tokës bujqesore për shkak të ndërrimit të destinimit të tokës bujqesore në tokë ndërtimore;
- Fragmentimi i madh i tokës bujqesore;

- Ndotja dhe degradimi i tokës bujqësore;
- Ndryshimet e fundit në kornizën ligjore për planifikimin hapësinor;
- E drejta e personave fizikë dhe juridik të huaj për të qenë pronarë të tokave bujqësore në Kosovë.

Shfrytëzimi i tokës bujqësore

Toka bujqësore në pronësi dhe e marrë me qira nga të tjerët, shfrytëzohet nga ekonomitë bujqësore, ekonomitë familjare, ekonomitë familjare bujqësore dhe subjektet juridike.

Ekonomia Bujqësore është një njësi e pavarur teknike dhe ekonomike e prodhimit, në të cilën një (1) Ekonomi Familjare ose (2) Subjekt Juridik kryen (3) veprimtari bujqësore, si aktivitet kryesor ose dytësor, nën një menaxhim të vetëm dhe ku i përdorin mjetet e përbashkëta të prodhimit (tokën, pajisjet, ndërtesat, etj.).

Ekonomia familjare - nënkupton individin, bashkësinë familjare apo bashkësinë tjetër të personave (individëve), të cilët jetojnë së bashku dhe janë të vendosur plotësisht ose pjesërisht në një ekonomi familjare, si dhe furnizohen me gjëra ushqimore e gjëra të tjera të mundshme elementare për jetesë. Anëtarët e këtij grupi mund t'i bashkojnë të ardhurat e tyre në një masë më të madhe apo më të vogël.

Ekonomi familjare bujqësore - është një familje apo komunitet i njerëzve, ku anëtarët e saj janë të angazhuar në prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor ose dytësorë që kanë një menaxhim të vetëm, duke përdorur mjetet e përbashkëta të prodhimit, të tilla si: toka, makinat, ndërtesat, etj. Ekonomia familjare bujqësore mund të prodhojë produkte bujqësore për shitje, për konsum vetanak ose për të dyjat.

Subjektet juridike - janë kooperativat bujqësore, bizneset individuale dhe format e tjera organizative me statusin e subjektit juridik, që janë regjistruar se kanë prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor dhe ndërmarrjet, institucionet dhe subjektet e tjera juridike që janë regjistruar në një aktivitet tjetër dhe të cilat kanë degë organizative ose pjesë të tjera organizative ku kryhet prodhimi bujqësor.

Toka e marrë me qira (gjithsej sipërfaqja e tokës bujqësore, pyjore dhe jo-pjellore) i referohet sipërfaqes së tokës që shfrytëzohet nga Ekonomitë Bujqësore (EB-ja), por që është në pronësi të të tjerëve. Dhe, kjo është shuma e sipërfaqes së tokës bujqësore (të shfrytëzuar dhe të pashfrytëzuar), pyjore dhe jopjellore. Toka shfrytëzohet në këmbim të

parave, në këmbim të mallrave dhe të shërbimeve, pa pagesë ose ngjashëm. Toka e përbashkët nuk është e përfshirë.

Toka e dhënë me qira (gjithsejtë sipërfaqja e tokës bujqësore, pyjore dhe jopjellore) i referohet sipërfaqes së tokës (tokës bujqësore, pyjore dhe jopjellore), të cilën EB-ja ia jep me qira një ekonomie tjetër, në këmbim të parave, mallrave dhe shërbimeve, pa pagesë ose ngjashëm.

Qiradhënësitë e tokës bujqësore janë: Agjencia Kosovare e Privatizimit (deri në fazën e privatizimit të asaj toke bujqësore), komuna, personat fizik dhe juridik, ekonomitë bujqësore, etj.

Gjithsejtë sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore që shfrytëzohet nga ekonomitë familjare për prodhimtarinë bujqësore në vitin 2014 ishte 413.635.16 hektarë që i përket 41.8% e gjithsejtë sipërfaqes së tokës në Kosovë.

Sipërfaqja mesatare e tokës së shfrytëzuar bujqësore për Ekonomi Bujqësore ishte 3.2 ha. Ekonomitë familjare kanë rreth 2-5 ha të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore e që përbejnë rreth 23.3% të sipërfaqës së përgjithshme.

Numri i Ekonomive Bujqësore në Kosovë është 130 775.

Sipas të dhënave të pranuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), toka bujqësore e privatizuar deri me tani është përafërsisht **30,217** ha. Ndërsa ka mbetur nën menaxhim të AKP-së përafërsisht rreth **40,000** ha tokë bujqësore.

Sipas kategorive të kulturave bujqësore del se ka rreth 180.381.11 ha ara; 131.949.39 ha drithëra; 3.215.26 ha vreshta; 3.519.66 ha plantacione të pemëve; 65.099 ha livadhe dhe 11.724.27 ha kullota.

Ujitja e tokës bujqësore

Për shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës rendësi ka edhe ujitja e tokës, ku nga regjistrimi i bujqësisë 2014 del së rreth 22.888.06 ha sipërfaqe e tokës është nën ujitje (duke mos përfshirë serrat nga xhami dhe najloni), ndërsa sipërfaqja potenciale e tokës bujqësore që mund të ujitet përmes pajisjeve të ndryshme dhe burimeve të ujit llogaritet të jetë rreth 43.490.75 ha.

Të dhënat e raportuara nga drejtoritë komunale për bujqësi tregojnë se gjatë vitit 2019, janë ujitur rreth 17,719 ha. Ujitja siç raportohet është realizuar në mënyra të ndryshme si ujitja formale e organizuar përmes kompanive të ujitjes, ujitja jo formale, ujitja e pa organizuar dhe ujitja individuale e cila bëhet nga burime të ndryshme ujore si lumenj, puse, etj.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Sipas të dhënave të grumbulluara nga Drejtoritë Komunale për Bujqësi është vlerësuar se gjatë vitit 2019, komunat të cilat kanë më së shumti sipërfaqe nën ujitje janë Prizreni, Gjakova, Peja, Klina, Podujeva, Shtërpca, Istogu, Vushtrria, etj. Përmes ujitjes formale dhe jo formale janë ujitur kryesisht kulturat si misri, pemët dhe perimet, duke përfshirë edhe sektorët tjerë të cekur në tabelën mbi ujitjen e tokave bujqësore. Ndërsa, ka edhe Drejtori Komunal, të cilat kanë raportuar që nuk kanë sipërfaqe nën ujitje.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Komuna	Burimi i ujitjes	Kulturat e ujitura	Sip. ujitur / ha
Deçani	Drini i Bardhë	Misër, pemë, perime	29
Gjakova	Radoniqi, lumenj, puset	Perime, misër, shalqi	2,030
Drenas	Ibër-Lepenci	Perime, misër, jonxhë	78
Gjilan	Puset	Perime, serra, fushë të hapur	405
Dragash	-	-	10
Istog	Drini i Bardhe	Misër, pemë, perime	581
Kaçanik	Lumenj	Misër, fasule, perime	467
Klina	Drini i Bardhë	Misër, perime, pemë	1,530
F. Kosova	L. Drenica, puse	Misër, jonxhë, perime	135
Kamenica	-	-	27
Mitrovica	Ibër-Lepenc	Perime, misër	437
Lipjan	Puset	-	149
Novobërda	-	-	118
Obiliq	Ibër-Lepenc	Misër, pemë, perime	526
Rahovec	Radoniqi	Perime, misër, shalqi	2,573
Peja	Drini i bardhë	Misër, pemë, perime	1,614
Podujevë	Lumi Llap, puset	Perime, misër, pemë	781
Prishtinë	Ibër-Lepenc	Patate, misër	220
Prizren	Radoniqi, Dukagjini	Misër, perime, foragjere	2,309
Shtime	Puse, lumenj	Perime, pemë, jonxhë	100
Shtërpca	Lumi Lepec,	Misër, perime, pemë	680
Suhareka	Lumenj, puse	Perime, pemë, jonxhë, lavërtari	452
Ferizaj	Lumenj, puse	Pemë, perime, misër	424
Vitia	Puse	Shalqi, patate	336
Vushtrri	Ibër-Lepenc	Patate, lakër, misër	487
H.Elezit	-	-	8
Mamusha	Puse, lumenj	Perime, misër	442
Junik	Drini i Bardhë	Jonxhë, misër, patate	237
Graçanica	Lumi, puse	Misër	462
Parteshi	Puse	Perime, misër, jonxhë	72

Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2019

Humbja e tokës bujqësore

Nuk ka të dhëna të sakta për sipërfaqen e tokës bujqësore të humbur gjerë më tani. Sipas Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore - Neni 8 Mbajtja e evidencës për tokat bujqësore 8.1. Personat juridik që merren më veprimtari bujqësore janë të obliguar të mbajnë evidencën për tokën bujqësore, të cilën e shfrytëzojnë apo e posedojnë. 8.2. Organi komunal kompetent për bujqësi është i obliguar të mbajë evidencë për tokën e papunuar, tokën e dhënë në shfrytëzim, dhe evidencën për tokën të cilës i është ndërruar destinimi i shfrytëzimit. 8.3. Organi kompetent komunal këto të dhëna ia dërgon Ministrisë sipas kërkesës së saj. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bazë të këtyre obligimeve ligjore ka kërkuar nga organi kompetent komunal për bujqësi që këto të dhëna t'ia dërgojnë Ministrisë, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Shfrytëzimi i Tokës Bujqësore për Prodhimtari Bujqësore

Sipas të dhënave të Anketës së Ekonomive Bujqësore, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore nuk ka pasur ndryshime të mëdha dhe ka qenë një trend i përafërt i shfrytëzimit për këtë periudhë kohore. Në vitin 2016 gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 415,826 ha, kurse në vitin 2017 vërehet një rritje e lehtë, duke vazhduar me rritje edhe në vitin 2018 ku sipërfaqe ishte 418,582 ha. Rritja e shfrytëzimit të tokës bujqësore vazhdoi edhe në vitin 2019 dhe në këtë rast sipërfaqja arriti në 420,141 ha, që tregon një ndryshim në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 për 0.4%.

Shfrytëzimi i tokës bujqësore sipas kategorive

	2016	2017	2018	2019	Ndryshi mi '19- '18	Ndryshi mi '19/'18 në %	Pjesëmarr ja në % 2019
Tokë e punueshme – ara	187,22 3	186,95 4	188,35 9	188,36 5	5.7	0.0	44.8
-Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	7,864	8,033	7,818	8,319	501.0	6.4	
-Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	457	467	468	518	49.7	10.6	
Kopsht	994	1,199	1,003	1,122	119.1	11.9	0.3
Plantacione të pemëve	5,493	6,247	7,687	9,244	1,557.3	20.3	2.2
Plantacione të vreshtave	3,112	3,199	3,272	3,367	95.3	2.9	0.8
Fidanishte	196	159	109	111	1.8	1.6	0.0
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	218,80 8	218,31 4	218,15 2	217,93 2	-220.2	-0.1	51.9
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	415,82 6	416,07 2	418,58 2	420,14 1	1,559.1	0.4	100

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19)

* Statistikat e prezantuara në këtë tabelë paraqiten në bazë të grupimit si në AEB të ASK-së dhe ka ndryshime me të dhënat e prezantuara në nënkapitujt 2.3.2 dhe 2.3.3 për arsye të ndryshimit në grupim (p.sh dredhëza tek nënkapitulli 2.1 sipas grupimit të ASK-së është e kategorizuar në perime ndërsa tek nënkapitulli 2.3.3 është e paraqitur tek pemët).


Sipërfaqe më të madhe të tokës së shfrytëzuar zënë livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e përbashkët) që përbën 51.9% të gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore. Kjo kategori e tokës për këtë periudhë kohore vërehet se nuk ka pasur ndryshime të

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

theksuara. Në vitin 2019 kjo sipërfaqe ishte 217,931 ha, që paraqet një rënie në krahasim me vitin 2018 për 0.1%.

Pas livadheve dhe kullosave sipërfaqe më të madhe si edhe në vitet tjera edhe në vitin 2019 ka kategoria e tokës së punueshme-ara, me pjesëmarrje prej 44.8%, që paraqet sipërfaqen prej 188,365 ha, ku përfshihet edhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (kulturë e parë) dhe e serrave (kulturë e parë).

Tokë e punueshme-ara (duke përfshirë perimet) dhe Livadhe e kullosa



Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('16,'17,'18,'19)


Në kuadër të sipërfaqes së tokës së punueshme-arave hyjnë edhe perimet në fushë të hapur si kulturë e parë (8,319 ha) dhe perimet në serra po ashtu si kulturë e parë (517 ha). Në vitin 2019 sipërfaqja e perimeve ka shënuar rritje në krahasim me vitet tjera, kështu që në krahasim me vitin 2018 kjo sipërfaqe është rritur për 6.4%. Edhe tek sipërfaqja me serra ka pasur rritje të sipërfaqes në krahasim me vitet tjera që janë prezantuar në tabelë e mësipërme dhe në figurën në vijim. Të dhënat tregojnë se në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 paraqitet shtim i sipërfaqes së kultivuar me perime në serrë si kulturë e parë për 10.6%. Sipërfaqe më e vogël me kopshte paraqitet në vitin 2016 me 994 ha, duke vijuar me rritje në vitet në vijim. Në vitin 2019 kjo sipërfaqe ishte 1,122 ha, që është një ndryshim në rritje prej 11.9% për dallim nga viti 2018.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Sipërfaqja e plantacioneve të pemëve në vitin 2016 ishte 5,493 ha, me rritje në vazhdimësi deri në vitin 2019, kur kjo sipërfaqe arriti në 9,244 ha. Në vitin 2019 kemi rritje prej 20.3% në krahasim me vitin 2018.

Sa i përket sipërfaqes së vreshtave nuk kemi ndryshime të theksuara në periudhën 2016-2019. Rritje në sipërfaqe të vreshtave paraqitet në vitin 2019 që tregon një rritje në krahasim me vitin 2018 për 2.9%.


Perime, kopshte dhe fidanishte, plantacione të pemëve dhe vreshtave



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19)

Kur flasim për shfrytëzimin e tokës bujqësore në vitin 2019 sipas kategorive kemi këtë ndarje: Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) me pjesëmarrje prej 52%, Tokë e punueshme-ara 43%, Perime (në fushë të hapur dhe serra si kulturë e parë), kopshte dhe fidanishte 2%, Plantacione të pemëve 2% si dhe Plantacione të vreshtave 1%.

Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2019



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19)

Madhësia e fermës

Gjithsej tokë e punueshme-ara në Kosovë paraqitet të jetë 44.8%, ku përshihet sipërfaqja e tokës, e cila është kultivuar rregullisht me kultura të ndryshme bujqësore ose është mbjellë me një renditje të caktuar të kulturave. Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë një viti të prodhimit bujqësor. Në vitin 2019, gjithsej toka e punueshme-ara rezulton të jetë 0.11 ha për kokë banori¹, ndërsa mesatarja e gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar e tokës bujqësore për kokë banori ishte 0.24 ha.

¹ Popullsia në Kosovë për vitin 2019 vlerësohet të jetë 1,782,115 banorë rezidentë

Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme-2019


Madhësia e fermës	Sipërfaqja (ha)	Pjesëmarrja (%)	Nr. i Ekonomive Bujqësore	Pjesëmarrja (%)
0 dhe më pak se 0.5	5,929	3.17	32,020	30.41
0.5 deri më pak se 1	12,065	6.45	18,355	17.43
1 deri më pak se 2	30,123	16.11	23,022	21.87
2 deri më pak se 5	65,202	34.86	24,231	23.01
5 deri më pak se 10	39,533	21.14	6,013	5.71
10 deri më pak se 20	16,013	8.56	1,203	1.14
20 deri më pak se 30	5,146	2.75	245	0.23
30 e më shumë	13,016	6.96	200	0.19
Gjithsej*	187,026	100	105,289	100

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2019

*Nuk janë përfshirë EB të komunave veriore

Në Kosovë madhësia e fermës prej 2 deri më pak se 5 ha përfaqëson 35% të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme arave, pasuar nga madhësia prej 5 deri më pak se 10 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%) dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha.

Madhësia e fermës sipas sipërfaqes 2019, në %




Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2019

Numri më i madh i ekonomive bujqësore është në madhësinë e fermës 0 deri më pak se 0.5 ha (30.4%), pasuar nga madhësia 2 deri më pak se 5 ha (23.0%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (21.9%) dhe grupet e tjera. Numri më i vogël i ekonomive bujqësore është në madhësitë: 20 deri më pas se 30 ha (0.2%) dhe 30 e më shumë (0.2%).

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Numri i ekonomive bujqësore sipas madhësisë së fermës 2019, (%)



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2019

Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokumen t i politikave , ligj ose akti nën- ligjor	Lidhja (linku) me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucio ni(-et) shtetëror (e) përgjegjë s(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Strategjia për Konsolidi min e Tokës 2010-2020	<a href="http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Konso
lidimin_e_Tokes_2010-2020.pdf">http://www.kryeministri- ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Konso lidimin_e_Tokes_2010-2020.pdf	MBPZhR MMPHI Agjencia Kadastra le e Kosoves; Komunat	Rregullimi i tokave Aprovimi i planeve zhvillimore komunale Mbikëqyrja e regjistrimit te dhënave kadastrale Regjistrimi i te dhënave ne RDPP
Strategjia Kombëtar e për te Drejtat Pronësore ne Kosove	<a href="http://kryeministri-ks.net/ëp-
content/uploads/docs/National_Strategy_an
d_Annexes_ALB.pdf">http://kryeministri-ks.net/ëp- content/uploads/docs/National_Strategy_an d_Annexes_ALB.pdf	AKP	Përgjegjëse për administrimi n dhe menaxhimin (privatizimin) e tokave bujqësore në

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

		MMPHI	pronësi shoqerore ; Përgjegjës për hartimin e politikave, zbatimin e ligjeve dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë resurset e ujit, ajrit, tokën dhe biodiversitetin, planifikimin hapësinor Urban dhe Rural , hartimi i hartës zonale të Kosovës, përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe administrimin e sistemit kadastral dhe standardeve
--	--	-------	---

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Ligji Nr. 02/L-26 Për Token Bujqësore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2450	MBPZhR	Hartimi i politikave dhe legjislacionit për shfrytëzimin, mbrojtjen dhe qiradhënien e tokës bujqësore, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit.
		MMPHI	Hartimi i Planit Hapësinor të Kosovës dhe Hartës Zonale të Kosovës.
		MAPL	Bën monitorimin e vlerësimit të ligjshmërisë të vendimeve të Kuvendit Komunal lidhur me ndërrimin e destinimit të

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

		Komunat	tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore ; Mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit për Tokën Bujqësore, mbajtjen e evidencës për tokën bujqësore të dhënë me qira, për tokat bujqësore të papunuara dhe sipërfaqen e tokës bujqësore, të cilave i është ndërruar detinimi nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore;
Ligji Nr. 04/L-040 Për Rregullim in e Tokës Bujqësore	https://gzk.rks- gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2804	MBPZhR	Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Rregullimin e Tokës;

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

		MMPHI	Hartimi i hartës
			Zonale të Kosovës ku janë
			përcaktuar edhe zonat
		AKK	në të cilat do të zhvillohen projektet e rregullimit të tokës;
			Mbikqyrë sistemin kadastral të komunave të Kosovës në të cilat lidhen edhe projektet e konsolidimit të tokës;
		Komunat	Hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale dhe Hartës Zonale Komunale, në të cilat është paraparë të zhvillohen projektet e rregullimit të

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			tokës, angazhon komisionin për rregullimin e tokës dhe siguron të dhënat për zhvillimin e projekteve dhe regjistrimin në RDPP.
Ligji Nr.03/L- 029 për Inspekcion në Bujqësi	https://gzk.rks- gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2609	MBPZhR Komunat	Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit për Tokat Bujqësore Mbikqyrja e zbatimit të Ligjit përmes inspektorëve komunal
Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës	https://gzk.rks- gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566	MBPZhR Agjencia Pyjore e Kosovës	Përgjegjëse për dhënie e pëlqimit për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore për qëllime jo pyjore. Menaxhimi dhe administrimi

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			n e pyjeve dhe tokave pyjore publike, mbikqyrjen e menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore private, si dhe zhvillimin e qëndrueshmërisë së pyjeve në Kosovë;
Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësino r	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865	MMPHI Komunat	Përgjegjëse për hartimin e Planit Hapësino r të Kosovës, Hartës Zonale të Kosovës dhe planeve për zonat e veçanta. Përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale të Komunës.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Ligji Nr.06 /L - 092 Për Dhënie në Shfrytëzi m dhe Këmbimi n e Pronës së Paluajtsh me të Komunës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18917	Komunat	Përgjegjëse per dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përfshirë tokën bujqësore dhe përfitimin e të drejtës së pronësisë për komunat mbi pronat, të cilat administrohen nga institucioni i shtetit, me qëllim të përmbushjes së interesit të përgjithshëm publik.
LIGJI Nr. 03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631	MMPHI	Shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit,

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			parandalimi n e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimi n e mjedisit të dëmtuar;
Ligji Nr. 03/L-233 Për Mbrojtjen e Natyrës	https://gzk.rks- gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716	MMPHI	Mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshë m të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
Ligji Nr. 04/L-159 Për Zonat Ekonomi ke	https://gzk.rks- gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8654	MBPZhR	Përgjegjëse për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore me qëllim të krijimit të zonave ekonomike.
		MINT	Përgjegjëse për

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			përcaktimin e vendndodhjes së zonës ekonomike bëhet në pajtim me planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike të miratuar nga Qeveria dhe planet përkatëse hapësinore komunale dhe qendrore, si dhe legjislacionit në fuqi që e rregullon fushën e planifikimit të përdorimit të tokës bujqësore dhe pyjore.
Ligji Nr. 06/L-005 Për Tatimin në pronën e	<u>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15984</u>	MFPT	Është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Paluajtshme			të tatimit në prona të paluajtshme - tokën bujqësore të papunuar dhe monitorimin e administrimit të tatimit në pronë.
Ligji Nr.04/L-034,për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.06/L-023 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-034 Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ndryshuar	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2773	AKP	Përgjegjëse për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin të ndërmarrjeve shoqërore (duke përfshirë edhe tokën bujqësore) deri në shitjen ose zgjidhjen në mënyrë tjetër.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

r dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L- 115 dhe Ligjin Nr.05/L- 080			
Ligji Nr. 04/L-013 Për Kadastër	https://gzk.rks- gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2757	AKK	Mirëmbanë kadastrin e palujtshmëri v, bën matjet shtetërore dhe kadatstrale , punën e gjeodezike dhe kadatrale, si dhe përfitimi.
		Zyret Kadastra le Komunal e	Regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale .
Ligji Nr.06/ L- 024 per Trajtimin e Ndertime ve pa Leje	http://gzk.rks- gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17767	MMPHI	Përgjegjëse për koordinimin e përgjithshem të trajtimeve pa leje, hartimin e

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

		Komunat	politikave mbajtjen e regjistrit mirëmbajtjen dhe administrimin e regjistrit të ndërtimeve pa leje, krijimin e mirëmbajtjeve dhe administrimin e bazës së të dhënave të legalizimit, regjistrimin dhe trajtimin e ndërtimeve të kategorisë III etj. Përgjegjës për zbatimin e Ligjit për kategorinë I dhe II të ndërtimeve pa leje.
Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530	MBPZhR MAPL	A) Zhvillimin ekonomik lokal; b) Planifikimin urban dhe rural; c) Shfrytëzimin

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			e tokës dhe zhvillimin;
Ligji Nr.05/L-087 për Kundërvajtje	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839	MBPZhR	Harmonizimi i dispozitave ndëshkimore të Ligjit për Tokën Bujqësore me dispozita ndëshkimore të Ligjit për Kundërvajtje
Udhëzim Administrativ MA-Nr.36/06, Për Rikultivimin e Tokës Bujqësore	https://www.mbpzhrs.net/repository/docs/967564_Udh._Adm._36-2006-shqip.doc	MBPZhR Komunitat	Rregullon metodologjinë e hartimit të projekteve për rikultivim sipas Nenit 18 të Ligjit për Tokën Bujqësore, i cili vlen vetëm për projektet për rikultivim të tokës bujqësore, që i nënshtrohet ndërrimit të përkohshëm të destinimit sipas nenit 17 të Ligjit

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			për Tokën Bujqësore.
Udhëzim Administrativ MA-Nr.37/06, Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga erozioni	https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/350155_Udh_Admi_37-2006_shqip.doc	MBPZhR Komunat	Rregullon marrjen e masave për: a.Parandalim in e humbjes së pakompenzu shme të shtresës së pllëshme të tokave bujqësore për shkak të praktikës së papërshtatshme bujqësore. b.Të ndihmoj shfrytëzuesit dhe pronarët e tokës bujqësore që në mënyrë të qëndrueshme ta ruajnë shtresën e pëlleshme të tokës bujqësore c. Për t'u mundësuar autoriteteve kompetente

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			të zbatojnë dhe mbështesin masat për mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni.
Udhëzim Administrativ MA-Nr.38/06, Për Kontrollin e Plleshmerisë së Tokës Bujqësore	https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/743562_Udh_Ad.38-2006_shqip.doc	MBPZhR IBK Komunat	Kontrolli i rregulltë i plleshmërisë së tokës bujqësore për: a.Parandalimin e humbjes së pakompenzueshme të plleshmërisë së tokave për shkak të praktikës së papërshtatshme bujqësore dhe plehërimit; b. Të ndihmojë pronarët dhe shfrytëzuesit e tokës bujqësore që në mënyrë të qëndrueshme të ruhet dhe

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			përmirësohet plleshmëria e dheut; c. Të sigurojë shfrytëzimin e duhur të plehrave minerale dhe organike; dhe d. Të jap pasqyrën e plleshmërisë së dheut për planifikimin bujqësor nga organet kompetente.
Udhëzim Administrativ MA- Nr.41/06, Për Ndërrimi n e Destinimi t të Tokës Bujqësore	https://www.mbpzhrs.net/repository/docs/959069_Udh_ad.41-2006_shqip.doc	MBPZhR Komunat	Cakton procedurën administrati ve dhe kriteret e vendosjes për ndërrim të përhershëm ose të përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore. Procedura e paraparë kërkon në veçanti

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			bashkëpunim të ngushtë të organeve përkatëse kompetente për planifikim hapësinor dhe bujqësi.
Udhezim Administrativ MA-Nr.11/2015 (MMPH) - Mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal	https://mmph.rks-gov.net/repository/docs/ministri-ua-11-15_349177.pdf	MMPHI MBPZhR	Mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal. Qëllimi i këtij U.A. është përcaktimi i përmbajtjes dhe kërkesave themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal. Të gjitha pjesët e Planit Zhvillimor

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

			Komunal të jenë në harmoni me njëra tjetrën, dhe të gjitha pjesët të jenë në harmoni me hartën e shfrytëzimit të planifikimit të tokës dhe të gjitha planet zhvillimore sektoriale.
--	--	--	--

Problemi kryesor, shkaqet dhe efektet

Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet - Rregullat janë të pakompletuara</u> Humbja e tokës bujqësore dhe zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore për shfrytëzimin e saj për prodhimtari bujqësore; Fragmentimi i tokës bujqësore; Degradimi i tokës bujqësore; Degradimi i kullotave në pronësi shoqërore, menaxhimi i dobët dhe mos aplikimi i meliorimeve dhe masave tjera agro-teknike të kullotave në pronësi shoqërore.
Problemi kryesor	Menaxhimi jo i qëndrueshëm i tokës bujqësore
Shkaqet	<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet:</u> Zbatimi jo i plotë i legjislacionit për tokën bujqësore dhe legjislacionit për Planifikim Hapësinor: • Komunat me rastin e hartimit të Planeve Zhvillimore Komunale nuk kanë marrë pëlqimin nga MBPZHR ne Projekt Planet Zhvillimore Komunale, por vetëm nga MMPHI; • Mos zbatimi i planeve zhvillimore komunale dhe planeve zhvillimore urbane nga organet e autorizuar komunale; • Mbikëqyrje jo e duhur e MBPZHR-së përmes inspektoreve dhe organeve tjera te autorizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore; • Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore dhe mosraportimi i komunave për këtë tek MBPZHR; • Shndërrimi i tokave bujqësore në tokë ndërtimore pa leje nga organet e autorizuar; • Shfrytëzimi i tokës për qëllime jobujqësore nën sistemet e ujitjes; • Shfrytëzimi i tokës bujqësore për ndërtime nën masën e komasacionit;

	• Mospërgatija e hartës zonale të Kosovës dhe hartave zonale të komunave; • Mungesa e inspektoreve të tokave bujqësore dhe organeve tjera të autorizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit; • Mospërmbushja e detyrave nga inspektorët komunal; • Mos aplikimi i masave mjedisore për mbrojtjen nga erozioni, vërshimet, përdorimi jo i drejtë i agroinputeve bujqësore; • Menaxhimi i dobët dhe mos aplikimi i meliorimeve dhe masave tjera agro-teknike të kullotave në pronësi shoqërore. Administrimi dhe menaxhimi jo i drejtë dhe jo i qëndrueshëm i tokës bujqësore në pronësi shoqërore: • Mungesa e një strategjie për menaxhim të tokës bujqësore në pronësi shoqërore; • Mungesa e një programi ekonomik - program investues për tokën bujqësore, e cila është tenderuar për privatizim; • Tenderimi i sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore dhe shfrytëzimit për veprimtari jo bujqësore; • Mungesë e mbikëqyrjes/monitorimit nga AKM-ja/AKP-ja gjatë dhe pas privatizimit të tokës bujqësore; • Mungesa e caktimit të çmimit minimal referent për privatizim të tokës bujqësore; • Privatizimi i tokës bujqësore pa metodën e Spin Of Special; • Privatizimi i tokës bujqësore të pronarëve privat, të cilët posedojnë aktvendime nga masa e komasacionit për pronat e tyre.
	<u>Rregullat janë të pakompletuara</u> Ndryshimet në legjislacionin për planifikim hapësinor ▪ Mos definimi specifik i obligimit të marrjes së pëlqimit nga MBPZHR-ja për Planin Zhvillimor Komunal për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore. Mangësitë në kornizën aktuale ligjore për tokën bujqësore ▪ Definimin jo i qartë i kompetencave të nivelit qendror dhe lokal (lidhur me dhënien e pëlqimit në draft-planin zhvillimor për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore për kategorinë I-

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

	IV dhe tokës pyjore në tokë për qëllime jo bujqësore-pyjore, mbikqyrja e zbatimit të Ligjit përmes inspektorëve ose organeve tjera të autorizuar; ▪ Korniza aktuale ligjore në Kosovë nuk e ndalon fragmentimin e tokës bujqësore me përjashtim në tokat, të cilat gjenden në masën e komasacionit; ▪ Ligji aktual për tokën bujqësore nuk parasheh krijimin e Fondit për tokën bujqësore; ▪ Ligji aktual për tokën bujqësore nuk rregullon të drejtat e personave të huaj fizik të jenë pronar të tokave bujqësore në Kosovë; ▪ Ligji aktual për tokën bujqësore nuk e definon qartë kompetencat e institucioneve në menaxhimin e kullotave në pronësi shoqërore; ▪ Ligji aktual për tokën bujqësore nuk e rregullon administrimin dhe menaxhimin e tokës bujqësore që aktualisht menaxhohet nga IBK.
--	---

Shkaqet e problemit

Rregullat nuk zbatohen siç duhet

Zbatimi jo adekuat i legjislacionit për tokën bujqësore dhe legjislacionit për planifikim hapësinor

Në bazë të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Neni 10 Pika 3), Komuna me rastin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal duhet të marrë pëlqimin nga MBPZhR-ja. Megjithatë që nga viti 2007 kur komunat kanë filluar të aplikojnë planet e tyre bazuar në Ligjin Nr.2003/14 , për Planifikimin Hapësinor komunat kanë marrë pëlqim vetëm nga MMPHI për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), i cili duhet të jetë në harmoni me Planin Hapësinor të Kosovës. Komunat, të cilat nuk e kanë të miratuar PZHK, tokën bujqësore e kanë shëndërruar në tokë për qëllime jo bujqësore me Vendim të Kuvendit Komunal, bazuar në Nenin 44 , paragrafi 44 pika 1, Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore. Në bazë të Nenit 81 të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, Ligji Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/04 Qershor 2008”, këto vendime Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), i ka dërguar në MBPZHR për shqyrtimin e ligjshmërisë së tyre. Në bazë të Raportit për zbatimin e Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore të Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural , Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, MMPHI-ja në kundërshtim me Ligjin

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

për Tokën Bujqësore, ka lëshuar pëlqime për planet zhvillimore komunale, për zgjerimin e zonës urbane në tokat bujqësore nën masën e komasacionit dhe nën sistemin e ujitjes. Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Neni 9 i Ligjit Nr.04/L-159, Për Zonat Ekonomike, dhe Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26, komunat kanë dërguar në MBPZHR kërkesë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore me qëllim të krijimit të zonave ekonomike.

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174,për Planifikim Hapësinor, Neni 13, MMPHI është e obliguar të harton Hartën Zonale për Kosovën, e cila është hartuar si draft i Hartës Zonale të Kosovë nga grupi punues. Sipas Neni 16,komunat duhet të përgatisin hartat zonale komunale pavarësisht nga Harta Zonale e Kosoves, ku përcaktohet edhe shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime bujqësore dhe jobujqësore, por disa nga komunat janë në fazën e hartimit të hartave zonale komunale.

Komunat, të cilat janë në proces të hartimit të Hartave Zonale janë: Peja, Deçani, Gjakova, Ferizaji, Drenasi, Podujeva, Gjilani, Lipjani, Fushë Kosova, Prizreni dhe Prishtina. Të gjitha komunat e Kosovës i kanë të aprovuara planet zhvillimore komunale , me përjashtim të komunave: Zubin Potoku, Leposaviqi, Zveqani dhe Mitrovica e Veriut, të cilat janë në fazën e hartimit të tyre.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, komunat janë të obliguara të raportojnë në MBPZHR për tokat e papunuara të dhëna me qira dhe sipërfaqen e tokës bujqësore, të cilës i është bërë ndërrimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Megjithatë, komunat nuk kanë raportuar asnjëherë deri më tani në MBPZHR për një gjë të tillë edhe pse Ministria ka parashtruar disa kërkesa.

Neni 15, Ligji Nr. 02/L -26 për Tokën Bujqësore ndalon ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jobujqësore. Përkundër kësaj kjo nuk është respektuar nga disa komuna, si psh. komuna e Prizrenit, Rahovecit, Gjakovës, Obiliqit, Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Drenasit, të cilat kanë ndërruar destinimin e tokës bujqësore nën sistemet e ujitjes (Radoniqi dhe Ibër Lepenci).

Sipas Nenit 30 të Ligjit Nr. Nr.04/L-40 për Rregullimin e Tokës, nën masën e rregullimit të tokës, në të cilën është bërë rregullimi i tokës, nuk lejohet ndryshimi i formës, drejtimit dhe zvogëlimi i sipërfaqës së parcelave kadastrale përveç në rastin e pëlqimit me shkrim nga Komisioni për Rregullimin e Tokës, i cili ka qenë funksional aty ku janë zhvilluar projektet e rregullimit të tokës. Dispozita e mësipërme nuk zbatohet për sipërfaqet që janë mbi 1ha. Ndërsa, sipas ligjit Nr.02/L-26 për tokat bujqësore në sistem të ujitjes ndalohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, përveç ngritjes së objekteve me rëndësi të veçantë publike.

Bazuar në Ligjin Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, Neni 38, Ministria është e obliguar të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij përmes inspektionit për Bujqësi dhe organeve tjera të autorizuara (inspektorët komunal për bujqësi, inspektorët komunal për ndërtim). Përkundër këtij obligimi, në mungesë të inspektorëve të tokave bujqësore dhe organeve tjera të autorizuara, MBPZhR-ja nuk ka mundur të bëjë mbikëqyrjen adekuate për zbatimin e Ligjit.

Nga ana tjetër, as komunat nuk kanë zbatuar legjislacionin përmes inspektorëve të tyre në mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, degradimi, ndotja, erozioni i tokës bujqësore, si dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i inerteve (mineralet sipërfaqesore: gurë, rërë, zhavor etj)

Mos aplikimi i masave mjedisore për mbrojtjen nga erozioni, vërshimet, përdorimi jo i drejtë i agroinputeve bujqësore

Ndërmarrja e masave mjedisore është realizuar pjesërisht si psh. pastrimi i shtretërve dhe rregullimi i bankinave të lumenjve, rregullimi dhe hapja e kanaleve të reja për ujitje dhe kullim në disa komuna, ripyllëzimi i sipërfaqeve të reja me qëllim të mbrojtjes nga erozioni dhe prodhimi i masës së gjelbërt dhe masës së drurit, regjistrimi i agroinputeve bujqësore bazuar në legjislacionin aktual, si dhe monitorimi i përdorimit të tyre nga ana e fermerëve përmes inspektoriatit.

Mos realizimi në nivelin e dëshiruar ka ardhur si pasojë e mungesës së projekteve, fondeve, pengesave rreth çështjeve pronësore juridike, etj.

Menaxhimi i dobët dhe mos aplikimi i meliorimeve dhe masave tjera agro-teknike të kullotave në pronësi shoqërore

Mos aplikimi i masave meliorative dhe masave tjera agro-teknike është si pasojë e mungesës së projekteve, fondeve dhe mos definimi i qartë i administrimit të kullotave në pronësi shoqërore.

Administrimi dhe menaxhimi jo i drejtë dhe jo i qëndrueshëm i tokës bujqësore në pronësi shoqërore

Procesi i administrimit, menaxhimit dhe privatizimit të tokës bujqësore në Kosovë ka filluar me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit-AKM i përshkruar në rregulloret e UNMIK-ut Nr. 2002/12, 2002/13 dhe 2003/13 dhe e ndryshuar me Rregulloren 2005/18. .

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik dhe ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-034 mbi

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

AKP-në. AKP bënë privatizimin e pronës shoqërore në tere territorin e Republikës së Kosovës dhe ky mandat rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, përmes Ligjit të AKP-së. Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të tyre, zhvillohet sipas Ligjit të AKP-së në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe ka të shtrirë autoritetin e vet në gjithë vendin përmes pesë zyrave të saja regjionale (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë), si dhe dy zyrave satelitore të hapura dhe funksionale në vendbanime me shumicë serbe në Shtërpçë e Leposaviq.

Në përputhje me objektivat e paraqitura në raportin e Planit të Punës për vitin 2019, AKP ka vazhduar me procesin e privatizimit të tokave dhe pronave shoqërore me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së aktiviteteve ekzistuese ose ndryshimit të llojit të aktiviteteve bujqësore të ndërmarrjeve, në mënyrë që të sigurohet nivel më i lartë i efikasitetit.

Sipërfaqja më e madhe e shitur e tokave bujqësore në hektarë ishte në regjionin e Pejës (11,407 ha), me pjesëmarrje në tokat e përgjithshme të privatizuara prej 38%, Prizreni (6,567 ha) 22%, Mitrovica (6,305 ha) apo 21%, Gjilani (3,199 ha) 11% dhe Prishtina (2,739 ha) që kishte pjesëmarrje prej 9%.

Në tabelën në vijim është paraqitur shitja e tokave bujqësore në Kosovë për periudhën 2005 -2019.

Shitjet e tokave bujqësore në Kosovë 2005-2019

Regjioni	Sipërfaqja në Ari	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqja e shitura (%)	Çmimi mesatar i shitjes €/Ari	Çmimi mesatar i shitjes €/ha	Vlera totale e shitjeve në €	Vlera e shitjes (%)
Prishtinë	273,894	2,739	9	228	22,784	62,402,831	43
Pejë	1,140,676	11,407	38	24	2,377	27,118,877	19
Prizren	656,738	6,567	22	44	4,412	28,973,658	20
Gjilan	319,851	3,199	11	52	5,231	16,730,996	12
Mitrovicë	630,511	6,305	21	15	1,484	9,355,898	6
Gjithsej	3,021,670	30,217	100	73	7,258	144,582,260	100


Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Në vitin 2005 janë privatizuar 1,436 ha të tokës bujqësore apo 4.8% të gjithsej tokave bujqësore të privatizuara. Në vitin 2006 dhe 2007 numri i hektarëve të tokës së privatizuar ishte 5,372 ha dhe 5,440 ha, respektivisht, me pjesëmarrje prej 18% secila. Një shitje më e madhe e tokave bujqësore ishte në vitin 2009, ku u privatizuan 6,790 ha, me një pjesëmarrje më të madhe krahasuar me vitet tjera. Nga viti 2010, ka pasur më pak shitje

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

të tokave bujqësore nga AKP-ja, kështu që nga ky vit kur shitja e tokës bujqësore ishte 2,318 ha, çdo vit tjetër ishte me numër të hektarëve më të ulët sesa vitin 2010. Në vitin 2019 u shitën ose u privatizuan 689 ha apo vetëm 2.3% nga totali i tokave bujqësore të shitura.

Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2019




Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal - AKP

Në vitin 2019, vlera totale e shitjeve për tërë sipërfaqet e privatizuara bujqësore që nga viti 2005 ishte 144.6 mil. €. Çmimi mesatar i shitjes në vitin 2019, për një hektar të tokës bujqësore në pesë regjionet e Kosovës ishte si në vijim: në regjionin e Prishtinës (22,784 €/ha), pasuar nga regjioni i Gjilanit (5,231 €), ai i Prizrenit (4,412 €), Pejës (2,377 €) dhe Mitrovicës (1,484 €). Në përgjithësi, në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 në të gjitha regjionet ka pasur rritje të çmimit për hektarë të tokës bujqësore të shitur nga AKP-ja.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Çmimi mesatar i shitjes sipas regjioneve, €/ha



Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal - AKP

Në grafikun e mësipërm janë paraqitur komunat që kanë pasur shitje të pronave bujqësore nga AKP, numri i ha të shitur, gjithsej çmimi i shitjes dhe çmimi për ha në komunë.

Struktura Pronësore e Organizatave Bujqësore 1988

	Gjithsej	Ekonomi deri 50 ha	51-100	101-300	301-500	501-1000	1001-2500	2501-5000	Ekonomi mbi 5000 ha
Organizata gjithsej	217	175	7	7	4	6	9	5	4
Organizatave bujqësore	124	95	3	4	2	3	8	4	2

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

të punës së bashkuar									
Kooperativat bujqësore	96	80	4	3	2	3	1	1	2
Sipërfaqja e tokës bujqësore në ha	82299	318	509	1226	1620	4488	16185	15072	42881
Organizatat bujqësore të punës së bashkuar	61550	134	213	646	866	2175	15023	12070	30423
Kooperativat bujqësore	20749	184	296	580	754	2313	1162	3002	12458

Burimi informacionit: Vjetari Statistikor i KSA Kosovës 1989

Sipas të dhënave të dërguara në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës, Shtator 2021, tokë bujqësore e pa privatizuar ka mbetur përafërsisht 40,000 ha.

Menaxhimi i privatizimit të tokës bujqësore deri më tani nuk ka dhënë efektet e pritshme pozitive për rritjen e prodhimtarisë bujqësore. Disa nga shkaqet, të cilat kanë ndikuar në menaxhimin joefikas të tokës bujqësore janë:

- Praktika e AKM-së/AKP-së, për privatizim ka rezultuar në tenderim të sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore;
- Privatizues të sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore kanë qenë kryesisht afaristë, të cilët këtë sipërfaqe të tokës bujqësore e kanë ndarë dhe me pas e kanë rishitur për çmime më të larta dhe kryesisht për qëllime të shfrytëzimit për veprimtari jo bujqësore;
- Fermerët, të cilët merren me veprimtari bujqësore dhe të cilët kanë pasur si synim rritjen e madhësisë së fermës së tyre, në të shumtën e rasteve nuk kanë përfituar nga ky proces;

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

- Në tokat bujqësore të privatizuara në disa raste ka praktika të mira dhe kjo tokë bujqësore është përdoruar për rritjen e prodhimtarisë bujqësore në mënyrë të suksesshme, por në të shumtën e rasteve në toket bujqësore të privatizua nuk është investuar fare sepse është blerë për qëllime spekulative dhe ndërtime, nuk ka rritje të prodhimtarisë bujqësore në tokën e privatizuar e në disa raste toka ka mbetur djerrinë;
- Tenderimi i tokës bujqësore është bërë pa program ekonomik - program investues në tokën bujqësore, e cila është planifikuar të privatizohet dhe nuk është bërë monitorim nga ana e AKM-së/ AKP-së pas privatizimit të tokës bujqësore;
- Administrimi i tokës bujqësore nga AKM-ja/ AKP-ja, nuk është bërë në mënyrë efikase, sepse kemi uzurpime dhe ndërrim të destinimit të tokave bujqësore, pra nuk janë zbatuar dispozitat e ligjeve në fuqi që e rregullojnë këtë çështje:
 - Privatizimi i tokës bujqësore në Kosovë është bërë në kundërshtim të parimeve të Komisionit Evropian ⁽¹⁾. Nuk është bërë një vlerësim i tregut të tokës bujqësore nga një institucion i autorizuar për t'i vendosur një çmim minimal referent nën të cilin çmim toka bujqësore nuk ka mundur të privatizohet. Informacioni: European Commission 1997 ⁽¹⁾ "Communication on State aid elements in sales of land and buildings by public authorities (97/C 209/03)";
 - Nuk është kërkuar nga personat fizik ose juridik, me rastin e tenderimit për privatizim të tokës bujqësore paraqitja e programit ekonomik dhe të bëhet vlerësim në bazë të këtij programi në rastin e përzgjedhjes së fituesit për privatizimin e tokës bujqësore për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore, të cilën do ta realizojnë në atë tokë bujqësore dhe pas privatizimit të monitorohen nga AKM-ja/ AKP-ja, me qëllim të realizimit të programeve me të cilat kanë tenderuar;
 - Tokat bujqësore nuk janë privatizuar me metodën e Spin Of Special (me pak përjashtime), me qëllim të monitorimit të investimeve të zotuara me rastin e konkurrimit për privatizim të tokës bujqësore, e cila do të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore pas privatizimit;
 - Toka bujqësore e privatizuar afër qyteteve edhe pse është tokë me pjellori të lartë në të shumtën e rasteve është privatizuar nga afaristë të ndryshëm me qëllim që të përdoret për zgjerimin e zonës urbane ose zonës industriale, e jo për qëllime bujqësore;
 - Është bërë privatizimi i tokës bujqësore në të cilën janë zhvilluar projektet e komasacionit në vitet e 80-ta, në Komunën e Obiliqit dhe brenda kësaj sipërfaqe të tokës bujqësore të privatizuar janë shitur edhe 14 ha të tokës

bujqësorë të pronarëve privat, të cilët posedojnë aktvendime nga masa e komasacionit për këto prona.

Rregullat janë të pakompletuara

Ndryshimet në legjislacionin për planifikim hapësinor

Ligji për Tokën Bujqësore është miratuar në vitin 2006, kurse Ligji Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor është miratuar në vitin 2013. Neni 5 i Ligjit për Planifikim Hapësinor parasheh këto dokumente të Planifikimit Hapësinor: Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës, Plane Zhvillimore Komunale për zonën urbane dhe rurale, si dhe Harta Zonale Komunale .

Por, Ligji Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor nuk ka definuar specifikisht obligimin e marrjes së pëlqimit nga MBPZhR-ja për Planin Zhvillimor Komunal për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore për klasën 1-4, sic përcaktohet me Ligjin për Tokën Bujqësore.

Sic është cekur edhe më lartë tek pjesa “**Zbatimi jo adekuat i legjislacionit për tokën bujqësore**”, në bazë të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Neni 10 Pika 3), Komuna me rastin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal duhet të marrë pëlqimin nga MBPZhR-ja, por që nga viti 2006 kanë marrë pëlqim vetëm nga MMPHI-ja për Planin Zhvillimor Komunal.

Definimi jo i qartë i kompetencave të inspektorëve të nivelit qendror dhe nivelit lokal

Në bazë të Raportit të Komisionit Parlamentar ka dualizëm në veprim, në mes të inspektorëve qendror dhe lokal dhe konflikt të kompetencave. Ligjit i mungon definimi i saktë i perkufizimit të inspektorit dhe nuk bën dallim në bazë të përgjegjësisë dhe autorizimeve të inspektorëve të nivelit qendror dhe lokal.

Sipas Ligji Nr. 03/L-029 për Inspektionin Bujqësorë Neni 5, Kompetencat e Inspektionit janë: 1. Mbikëqyrjen inspektuese të tokës bujqësore e kryejnë inspektorët e nivelit qendror në tërë territorin e Republikës së Kosovës. 2. Inspektorët komunal kryejnë inspektimin brenda territorit të komunës sipas autorizimeve ligjore.

Ligji i Tokës Bujqësore nuk përcakton autorizimet ligjore në bazë të të cilave do të vepronte inspektori komunal. Çështja e inspektimit pritet të rregullohet me Ligjin e ri për Inspektoriat, i cili është në proces të hartimit.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Korniza aktuale ligjore në Kosovë nuk e ndalon fragmentimin e tokës bujqësore përveç në tokat bujqësore që gjenden nën masën e komasacionit.

Të drejtat e personave fizikë dhe juridik të huaj për të qenë pronarë të tokës bujqësore në Republikën e Kosovës.

Çfarë ishte situata në Bashkimin Evropian për shtetet, të cilat pretendonin të jenë pjesë e saj?

Tregu i përbashkët i Bashkimit Evropian (BE) bazohet në parimin e katër lirive të lëvizjeve: mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Bazuar në Rregulloret në fuqi, BE nuk pranon kërkesat e vendeve kandidate po që se nuk i përmbushin obligimet në zbatimin e parimeve të cekura më lartë, sepse ka ndikim të rëndësishëm në konkurrencën dhe në funksionimin e tregut të përbashkët. Traktati për krijimin e Komunitetit Evropian (Art.56) ndalon në mënyrë specifike të gjitha kufizimet në lëvizjen e kapitalit midis vendeve të Shteteve Anëtare dhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta, megjithëse Shtetet Anëtare mund të mbajnë disa kufizime në marrëdhëniet me vendet jashtë BE-së. Liria e lëvizjes së kapitalit në Komunitetin Evropian përcaktohet në Kapitullin 4 të *Acquis (acquis communautaire)*. Detyrimet e Kosovës në këtë drejtim përcaktohen në Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), e cila ka hy në fuqi 01 prill 2016.

Problemi më i madh ishte kryesisht e drejta e jorezidentëve për të blerë tokë bujqësore. Bullgaria, Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Sllovakia kërkuan një moratorium prej 10-18 vitesh për shitjen e tokës bujqësore. Duke vënë në dukje se kjo është një çështje politike shumë e ndjeshme, Komisioni Evropian në maj 2001 ju propozojë pesëmbëdhjetë vendeve Anëtare të lejojnë vendet kandidate të kufizojnë blerjen e tokës bujqësore për qytetarët e tjerë të BE –së, gjatë tranzicionit shtatë vite pas pranimit në BE. Shumica e anëtarëve të rinj ranë dakord edhe për mundësinë e një zgjatjeje një periudhë tranzicioni shtatëvjeçar për tre vite të tjera nëse aktivizohet klauzolë e veçantë mbrojtëse e tokës bujqësore nga blerja e shtetasve fizikë dhe juridik të huaj.

Shitja e tokës bujqësore është një çështje shumë e ndjeshme, por nuk duhet të kesh frikë, sepse Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) nuk u hap derën blerjes së tokës bujqësore për qytetarët e BE –së, pa asnjë kufizim, tha Komisioneri Evropian për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural, Phil Hogan (shtator 2019).

Cilat janë Udhëzimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë?

Komisioni Evropian nuk ju mohon të drejtën vendeve anëtare, të kufizojnë shitjen e tokës bujqësore, në mënyrë që të ruajnë komitetin e tyre bujqësor dhe të promovojnë bujqësi të qëndrueshme, por kjo duhet të jetë në harmoni me legjislacionin e BE-së, veçanërisht duhet të jetë në harmoni me rregullat e lëvizjes së lirë të kapitalit.

Udhëzimet janë në përputhje me praktikat gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë:

Disa kufizime janë të pranueshme si:

- Miratimi paraprak nga autoriteti kombëtar i blerjes së tokës bujqësore;
- Kufizimet e madhësisë së sipërfaqesë;
- E drejta prioritare që lejojnë kategori të caktuara të blejnë tokë bujqësore;
- E drejta e para-blerjes së tokës bujqësore për kategori të caktuara;
- Ndërhyrja e shtetit në çmime etj.

Transformimi i tokës bujqësore nga pronësia shoqërore në pronësi shtetërore

Historiku i krijimit të tokës bujqësore në pronësi shoqërore

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, gjatë periudhës socialiste është kryer reforma agrare me anë të së cilës u nxorën dispozitat juridike si më të rëndësishme: Ligji i Reformës Agrare dhe i Kolonizmit (Gaz. Zyrtare e RPFJ, NR.64/45, Ligji për Reformën Agrare dhe Kolonizmin e Brendshëm (Gaz. Zyrtare e RPFJ, NR.39/45, 5/48, 11/49, 34/56 dhe 2/58, Ligji për shpalljen pronë e përgjithshme popullore të djerrinave, kullotave, pyjeve dhe tokës pyjore (Gaz. Zyrtare e RPS, NR.1/48, Ligji mbi Fondin e Tokës Bujqësore të pronës së përgjithshme popullore dhe ndarjen (dhënie) e tokës organizatave bujqësore (Gaz. Zyrtare e RPFJ, NR.22/53, Ligji Themelor për Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore (Gaz. Zyrtare e RPFJ, NR.25/65).

Në bazë të këtyre ligjeve toka bujqësore është marrë nga pronarët, të cilët kanë poseduar tokë bujqësore të punueshme më shumë se 10 ha, pronarët e tokës bujqësore, të cilët nuk merren me aktivitete bujqësore më shumë se 3 ha, nacionalizimi i tokës bujqësore nga armiq të shtetit, bashkëpunorët e armikut, ata të cilët nuk kanë punuar tokën bujqësore në bazë të dispozitave të Ligjit Themelor për Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore (Gaz. Zyrtare e RPFJ, NR.25/65, etj).

Nga kjo sipërfaqe e tokës bujqësore e sekuestruar i është shtuar fondit të tokës bujqësore si pronë e përgjithshme popullore-pronë shoqërore.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Me Kushtetutën e ish RSFJ-es, vitin 1963, Neni 21 përcakton se fermerëve u garantohen të drejtat pronësore për tokën bujqësore të punueshme me së shumti deri në 10 ha. Në kohën e rregullimit të sistemit shoqëror socialist erdhi deri tek zhvillimi i numrit të madhë të kombinateve bujqësore, të cilëve ju dhanë sipërfaqe të mëdha të tokës bujqësore në shfrytëzim, e cila me herët u ishte marrë pronarëve privat, përmes dispozitave ligjore të cekuar më lart.

Prandaj statusi ligjor i tokës bujqësore në pronësi shoqërore duhet të ndryshojë dhe të kalojë në pronësi shtetërore, sepse ngritet një dilemë se kush është mbajtësi i pronësisë mbi një tokë të tillë?

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e vitit 2001 ka përcaktuar se në Kosovë do të ketë pronë publike, shtetërore dhe shoqërore. Korniza Kushtetuese në mënyrë eksplicite ka theksuar se autoriteti për të administruar me pronën publike, shtetërore dhe shoqërore si dhe për rregullimin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore mbetet një “kompetencë e rezervuar” e UNMIK-ut. Nën këtë kompetencë, UNMIK-u me Rregulloren 2002/12 themeloi një program të bartjes së të drejtës së shfrytëzimit të patundshmërive në pronësi shoqërore, i cili do të transformojë-bartë, për kohë të caktuar, të drejtën e shfrytëzimit të patundshmërive të regjistruara në emër të ndërmarrjeve shoqërore. Ky transformim është bërë në formë të qira mbajtjes dhe është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13, Mbi transformimin e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme shoqërore.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka ndryshuar natyrën juridike të pronës shoqërore. Kushtetuta e vitit 2008, i referohet pronës shoqërore. Neni 159.2 i Kushtetutës ka përcaktuar se të gjitha interesat shoqërorë mbi pronën dhe ndërmarrjet në Kosovë janë në pronësi të Republikës së Kosovës. Mirëpo, ndryshimet dhe plotësimet e Kushtetutës në vitin 2012 e kanë fshirë nenin 159.2 duke krijuar huti nëse transformimi i pronës shoqërore në pronë shtetërore është ende i vlefshëm, nëse është anuluar, apo nëse transformimi i pronës shoqërore në pronë shtetërore është përmbyllur në vitin 2008 në mënyrë që të mos ketë më nevojë që ajo dispozitë të ekzistojë në Kushtetutë. Sipas kësaj privatizimi i pronës shoqërore, i interpretuar në përputhje me Kushtetutën, është tani e tutje privatizimi i pronës shtetërore.

Kjo dispozitë ka qenë e rëndësishme në dy aspekte: (i) e ka njohur që prona shoqërore ka qenë lloj i pronës që ka ekzistuar në kohën kur është miratuar Kushtetuta, dhe (ii) e ka transformuar pronën shoqërore në pronësi të Republikës së Kosovës përmes veprimit të drejtpërdrejtë të Kushtetutës. Transformimi i pronës shoqërore në pronë shtetërore është konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Megjithatë ka hapur dilema nëse prona shoqërore vazhdon të ekzistoj si një lloj i të drejtës pronësore apo transformimi i pronës shoqërore në pronë shtetërore ka përfunduar.

Menaxhimi i qëndrueshëm i kullotave në pronësi publike -shoqërore

Kullotë– (përkufizimi bazuar në Ligjin Nr.02L/-26 për Tokën Bujqësore) – “Toka e mbuluar kryesisht me vegjetacion natyrorë bimor e cila shërben për kullotjen, lëshuarjen dhe pushimin e bagëtisë”.

Menaxhimi i qëndrueshëm i kullotave në pronësi shoqërore si një koncept dinamik dhe i zhvilluar ka për qëllim të mirëmbajë ato përmes aplikimit të masave meliorative dhe masave tjera agro-teknike, të rris vlerën ekonomike, sociale dhe mjedisore të të gjitha llojeve të kullotave në pronësi shoqërore.

Të parandalojë shfrytëzimin e pakontrolluar dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, përmes lëvizjes nomade të kafshëve në kullota. Në prodhimin blegtoral, kullotat natyrore janë një burim i rëndësishëm i ushqimit vuluminoz, pavarësisht se si ato përdoren për kullotje, kositje ose kombinim. Pavarësisht nga mënyra e origjinës dhe përdorimit të kullotave, ne duhet të zbatojmë masa agroteknike mbi to dhe t'i përmbahemi mënyrës së drejtë të shfrytëzimit, si dhe duke marrë parasysh numrin e turnuseve të kullotjes. Shfrytëzuesit e kullotave, bagëtitë e të cilëve kullosin në kullota janë të detyruar t'i përmbahen mënyrës dhe kohës së kullotjes së bagëtisë të përcaktuar nga pronari. Kërkohej që të definohet statusi ligjor i kullotave në pronësi shoqërore- të kalojnë në pronësi shtetërore. Definimi i çartë i kompetencave ligjore, se cili institucion qendror ose lokal të merret me menaxhimin e kullotave në pronësi shoqërore. Mënyra e shfrytëzimit të kullotave në pronësi shoqërore. Kullotat e larta në pronësi shoqërore janë të shpërndara kryesisht në komunat: Deçan, Junuik, Pejë, Istog , Prizren, Dragash etj.

Sipas të dhënave të siguruara nga Drejtoria për Kullota Rethi i Pejës dt. 21.11.1959

Komuna e Pejës

<i>Vendi ku gjinden kullotat</i>	<i>Sipërfaqe për ha</i>
<i>-Mileshevc</i>	<i>699 ha</i>
<i>-Bjeshka e Lumbardhit</i>	<i>1.549 ha</i>
<i>-Maja e Lubeniqit</i>	<i>140 ha</i>
<i>-Shtedimi</i>	<i>2.027 ha</i>

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

<i>-Rusolija</i>	<i>2.039 ha</i>
<i>-Zhlebi</i>	<i>1.347 ha</i>
<i>-Bjeshka e Bellopojes</i>	<i>1.50 ha</i>
<i>-Hajla</i>	<i>500 ha</i>
<i>-Stankaj</i>	<i>300 ha</i>
<i>-Leqinati i Drelajve</i>	<i>100 ha</i>
<i>Sipërfaqja e përgjithshme</i>	<i>8.851 ha</i>

Komuna e Istogut

Vendi ku gjinden kullotat Sipërfaqe për ha

<i>-Bjeshka e Sejnoves</i>	<i>1.317 ha</i>
<i>-Bjeshka e Thate</i>	<i>3.698 ha</i>
<i>-Uji i zi</i>	<i>1.182 ha</i>
<i>-Degjenica</i>	<i>164 ha</i>
<i>-Jerabinje</i>	<i>622 ha</i>
<i>Sipërfaqja e përgjithshme</i>	<i>6.980 ha</i>

Komuna e Decanit

Vendi ku gjinden kullotat Sipërfaqe për ha

<i>-Bjeshka e Bogiqes</i>	<i>886 ha</i>
<i>-Ereniku</i>	<i>911 ha</i>
<i>-Rrasa e Zogut</i>	<i>990 ha</i>
<i>-Pllaqice e Vokshit</i>	<i>1.580 ha</i>
<i>-Bjeshka e Decanit-Lloqanit</i>	<i>361 ha</i>
<i>-Qurshiza</i>	<i>439 ha</i>
<i>-Roshkodoli</i>	<i>1.292 ha</i>
<i>-Maja e Strellcit</i>	<i>563 ha</i>

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

-Pleqe *186 ha*

Sipërfaqja e përgjithshme *7.178 ha*

Komuna e Pejës *8.851 ha*

Komuna e Istogut *6.980 ha*

Komuna e Deqanit *7.178 ha*

Gjithsejtë *23.009 ha*

Në Komunën e Dragashit gjenden 22.500 ha të “SharrProdhimit”, ndërsa sipërafqet e tjera të kullotave në pronësi shoqërore gjenden dhe në bjeshkët e tjera të Komunës së Dragashit, Prizrenit etj.

Administrimi dhe Menaxhimi i tokave bujqësore që aktualisht menaxhohen nga Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) në Pejë;

Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë është themeluar me Vendim të ish Kuvendit të Kosovës me dt. 30 Qershor 1949 me emrin “ Instituti për hulumtime bujqësore”. Në pronësi të Institutit gjenden rreth 300 ha tokë bujqësore. Administrimi dhe menaxhimi i kësaj toke bujqësore kërkon që të rregullohet me Ligj.

Administrimi/të drejtat pronësore të tokës bujqësore të IBK-së, në Certificate të Drejtave Pronësore figurojnë me emra të ndryshëm si:

- Pronë Shoqërore (P.Sh.) Instituti Biotenik;
- Pronë Shoqërore (P.Sh.) Institutit za poljoprivedonom istarzhvanje;
- Pronë Shoqërore (P.Sh.) Instituti Biotenik- Fidanishtja Bujqësore.

Zotërimi/pronësia duhet të rregullohet me Ligj, në mënyrë që të definohet qartë çështja e pronës të tokës bujqësore që aktualisht menaxhohen nga IBK-ja.

Menaxhimi i tokës bujqësore (IBK)

Toka bujqësore në disa vende është dhënë me qira për aktivitete bujqësore. Toka bujqësore në disa vende, si në Komunën e Prishtinës, e cila gjendet buzë magjistrales Prishtinë-Fushë Kosovë, Zona Industriale, që nga viti 2000 është dhënë me qira dhe nga ajo kohë përdoret për aktivitete jobujqësore. Këto toka bujqësore me Planin Zhvillimor Urban të Komunës së Prishtinës (2012), janë përcaktuar si tokë urbane. Toka bujqësore në disa vende është uzurpuar dhe shfrytëzohet pa autorizim të organeve kompetente.

Efektet e problemit

Humbja e tokës bujqësore dhe zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore për shfrytëzimin e saj për prodhimtari bujqësore

Zbatimi jo i plotë i legjislacionit për tokën bujqësore dhe Legjislacionit për Planifikim Hapësinor Rural ka si rezultat zvogëlimin e sipërfaqes së tokës bujqësore për prodhimtari bujqësore me qëllim të sigurimit të ushqimit dhe të mirave materiale për popullatën e Kosovës dhe zvogëlimin e importit të produkteve bujqësore. Shfrytëzimi i tokës bujqësore për ndërtime nën masën e komasacionit dhe sistemit të ujitjes ndikon në zvogëlimin e sipërfaqes së tokës bujqësore që gjindet nën masën e komasacionit dhe sistemit të ujitjes si potencial shumë i favorshëm për prodhimtari bujqësore, i cili jep sigurimin e rendimenteve të larta dhe të sigurta për konsum. Mospërgatija e Hartës Zonale të Kosovës dhe Hartave Zonale të Komunave ndikon në humbjen e tokës bujqësore kualitative, duke ndikuar që zonat urbane të mos kenë një përkufizim të vijës ndërtimore dhe ndërtimet të realizohen në tokat bujqësore duke ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqes së tyre dhe përdorimin e tyre për prodhimtari bujqësore. Po ashtu, mungesa e inspektorëve të tokave bujqësore dhe organeve tjera të autorizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit ndikon në humbjen, degradimin, parcializimin dhe përdorimin e tokës bujqësore, si dhe inicimin e procedurave në organet kompetente (Gjykatat), për personat fizik dhe juridik, të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjet në fuqi.

Ligji aktual për Tokën Bujqësore nuk parasheh krijimin e Fondit për Tokën Bujqësore, i cili si instrument do të ishte stimulativ për zhvillimin e projekteve të rregullimit të tokës bujqësore dhe zhvillimit të projekteve të ripërtëritjes së zonave rurale. Për shkak të mos definimit specifik të obligimit të marrjes së pëlqimit nga MBPZhR-ja për Planin Zhvillimor Komunal për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore, komunat hartojnë plane zhvillimore komunale, të cilat nuk e argumentojnë në mënyrë objektive zgjerimin e zonës urbane drejt zonave rurale të Republikës së Kosovës.

Humbja e tokës bujqësore do të sjellë pasoja, ngase është resurs natyror i parenovueshëm dhe e mirë e përgjithshme, si resurs bazë për zhvillim, mirëqenie sociale dhe perspektivë për ardhmëri të gjeneratës së tanishme dhe të ardhshme, mjet i pazëvendësueshëm për prodhimin e ushqimit dhe të mirave tjera materiale në të ardhmen. Zvogëlimi i potencialit për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe sigurimin e ushqimit për popullatën nga prodhimtaria vendore, duke rritur edhe varësinë e vendit nga importi i prodhimeve bujqësore dhe agro industriale.

Fragmentimi i tokës bujqësore

Njeri nga faktorët kryesor që në Kosovë nuk mundemi të zbatojmë atë që në ekonomi njihet “Ekonomitë e Shkallës” është sipërfaqja me madhësi të vogël të parcelës së tokës bujqësore e fragmentuar dhe pjesa më e madhe e tyre u takojnë fermerëve ekzistencial.

Korniza aktuale ligjore në Kosovë nuk e ndalon fragmentimin e tokës bujqësore përfshirë ligjet në fuqi që rregullojnë çështjen e trashëgimisë, pronës, kadastrit, familjes dhe çështjes gjinore. Si pasojë vjen deri te zvogëlimi dhe parcializimi i sipërfaqes së tokës bujqësore dhe rrjedhimisht sipërfaqe të vogël të tokës bujqësore për ekonomi familjare. Kjo paraqet disavantazh për sektorin e bujqësisë, rritjen e konkurrueshmërisë së fermës dhe dekurajim të fermerëve për t’u marrë me bujqësi.

Degradimi i tokës bujqësore

Si pasojë e menaxhimt të dobët, mos aplikimit të masave meliorative, masave tjera agro-teknike, si dhe mos aplikimi i masave mjedisore për mbrojtjen nga erozioni, ndotja, vërshimet, përdorimi jo i drejtë i agroinputeve bujqësore etj., kanë shkaktuar degradimin e tokës bujqësore.

Degradimi i tokës bujqësore është i definuar si një grup procesesh që ndikojnë në uljen e kapacitetit aktual dhe potencial të tokës për të prodhuar prodhime bujqësore në aspektin cilësor dhe sasior.

- Degradimi i tokës bujqësore në Kosovë vlerësohet se mund të shkaktohet nga katër faktorë:
- Klimatikë;
- Dheut;
- Topografik, dhe
- Faktorit njeri.

Të gjithë këta faktorë kanë ndikim në degradimin fizik, kimik dhe biologjik të tokës bujqësore. Ndotja dhe degradimi i tokës bujqësore është dukshëm i ndikuar nga deponitë ilegale inerte të vendosura në tokën bujqësore, ndërtimet ilegale për shkak se ato janë ngritur në tokë pjellore bujqësore dhe rajone të gjelbërta pa infrastrukturë adekuate. Ka një numër të vendbanimeve të paplanifikuara të ndërtuara afër lumenjve dhe ujërat e zeza të patrajtuar derdhen në lumenj, të cilët shfrytëzohen për ujitjen e tokës bujqësore, por janë edhe ndotës potencialë të ujarëve nëntokësore.

Degradimi i kullotave në pronësi shoqërore

Menaxhimi i qëndrueshëm i kullotave në pronësi shoqërore si një koncept dinamik dhe i zhvilluar ka për qëllim të mirëmbajë ato përmes aplikimit të masave meliorative dhe masave tjera agro-teknike, të rrisë vlerën ekonomike, sociale dhe mjedisore të të gjitha llojeve të kullotave në pronësi shoqërore. Të parandaloj shfrytëzimin e pakontrolluar dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse përmes lëvizjes nomade të kafshëve në kullota.

Në mungesë të një strategjie për administrim dhe menaxhim të kullotave në pronësi shoqërore dhe mos aplikimit të masave meliorative dhe agroteknike kemi humbje të vlerës ekonomike të kullotave, degradim, përhapje të sëmundjeve ngjitëse të kafshëve për shkak të lëvizjeve nomade të tyre dhe zvogëlim të fondit të kullotave në pronësi shoqërore.

Palët me interes

Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku/qet me të cilat është e lidhur pala	Efekti/et me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
MBPZhR	Mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit për Tokën Bujqësore dhe përdorimit të agroinputeve bujqësore; Mungesa e inspektorëve të tokës bujqësore përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit; Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore; Shëndrrimi i tokës bujqësore për qëllime jo bujqësore nën masen e komasacionit dhe sistemin e ujitjes;	Humbja e fondit të tokës bujqësore; Degradimi i tokës bujqësore; Ndërrimi i pa autorizuar i destinimit të tokës bujqësore;	MBPZhR është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit dhe mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit për tokën bujqësore.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

MMPHI	Mos përgatitja e Hartes Zonale të Kosovës ; Mos zbatimi i Planeve Zhvillimore Komunale dhe Planeve Zhvillimore Urbane nga organet e autorizuar komunale Mos aplikimi i masave mjedisore për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe vërshimet. Menaxhimi i dobët dhe mos aplikimi i meliorimeve dhe masave tjera agro-teknike të kullotave në pronësi shoqërore	Degradimi i tokës bujqësore Degradimi i kullotave në pronësi në shoqërore	Përgjegjëse për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës, Hartës Zonale të Kosovës dhe mbikqyrjen e zbatimit të planeve zhvillimore komunale dhe Hartën Zonale Komunale . Mbikëqyrjen e aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit duke përfshirë resurset e ujit, ajrit, tokën dhe biodiversitetin . Inspektimin dhe zbatimin e masave mjedisore për mbrojtjen nga erozioni dhe vërshimet. Mbrojtjen e Parqeve Nacionale të Kosovës.
Komunat	Komunat në rastin e hartimit të Planeve Zhvillimore Komunale nuk kanë marrë pëlqim	Zvoglimi i sipërfaqes së tokës bujqësore për shfrytëzimin e saj për prodhimtari bujqësore	Komunat janë përgjegjëse për hartimin e planeve zhvillimore komunale (duke përfshirë zonën urbane dhe rurale), Hartës

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

	nga MBPZhR-ja, por vetëm nga MMPHI Mos përmbushja e detyrave nga inspektorati komunal Shfrytëzimi i tokës për qëllime jobujqësore nën sistemin e ujitjes Shfrytëzimi i tokës bujqësore nën masën e komasacionit	Fragmentimi i tokës bujqësore Degradimi i tokës bujqësore	Zonale dhe zbatimin e këtyre planeve. Komunat bëjnë regjistrimin në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme RDPP , duke mos pasur kufizime në fragmentimin e tokës bujqësore.
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)	Administrimi dhe menaxhimi jo i drejtë dhe jo i qëndrueshëm i tokës bujqësore në pronësi shoqërore Mungesa e një Strategjie për menaxhimin e tokës bujqësore në pronësi shoqërore Mungesa e caktimit të një cmimi minimal referent për	Fragmentimi i tokës bujqësore Degradimi i tokës bujqësore	Pas procesit të privatizimit të sipërfaqeve të mëdha të tokave bujqësore janë fragmentuar dhe më pas janë rishitur me çmime me të larta, kryesisht për qëllime të shfrytëzimit për veprimtari jo bujqësore.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

	privatizimin e tokës bujqësore Mungesa e një programi ekonomik – program investues për tokën bujqësore, e cila është tenderuar për privatizim		
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV)	Përdorimi jo i drejtë i agroinputeve bujqësore	Degradimi i tokës bujqësore	Mbikqyrjen e aktiviteteve për përdorimin e drejtë të agroinputeve bujqësore
Agjencia Pyjore e Kosovës (APK)	Menaxhimi i dobët dhe mos aplikimi i meliorimeve dhe masave tjera agro-teknike të kullotave në pronësi shoqërore	Degradimi i kullotave në pronësi shoqërore	Dhenia me qira e kullotave në pronësi shoqërore. Aplikimi i meliorimeve dhe masave tjera agro-teknike të kullotave në pronësi shoqërore.

Praktikat e vendeve të rajonit lidhur me menaxhimin e tokës bujqësore

Praktikat e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore, administrimit, privatizimit dhe menaxhimin e tokës bujqësore dhe kullotave në pronësi shtetërore – shoqërore, si dhe e drejta e personave fizikë dhe juridikë të huaj që të kenë tokë bujqësore në pronësi në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.

Shembulli i Republikës së Kroacisë

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore

Bazuar në Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RK Nr. 39/13 dhe plotësim Ndryshimi i Ligjit për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RK Nr. 48/15, Ministria jep mendim në propozim Strategjinë e Rregullimit Hapësinor të Shtetit, si dhe Programin e Rregullimit Hapësinor të Shtetit.

Para aprovimit të Planeve Zhvillimore të Regjioneve dhe Planeve Zhvillimore me karakteristika të veçanta duhet të merret mendimi i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ndërsa pëlqimi i Ministrisë në draftin përfundimtar të propozimit të Planit Hapësinor të Komunave.

Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shtetërore (shoqërore) në Republikën e Kroacisë

Toka Bujqësore shtetërore nuk është subjekt i Privatizimit. Toka bujqësore menaxhohet nga Agjencia për Tokën Bujqësore nën administrimin e MBPZHR-së në harmoni me Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RK Nr. 39/13 dhe plotësim Ndryshimi i Ligjit për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RK Nr. 48/15 . Toka bujqësore shtetërore në Republikën e Kroacisë kryesisht jepet me qira bazuar në tenderët publikë lidhjen e kontratave të qirasë dhe monitorimin e tyre, por mund edhe të shitet, por me sipërfaqe të kufizuar, varësisht se a gjendet në vendet kontinentale apo bregdetare, kushte shumë specifike dhe privatizues të tokës bujqësore janë vetëm fermerët (personat fizik) ose personat juridik që merren me aktivitete bujqësore

Qiradhënia e kullotave në pronësi shtetërore

Kullotat në pronësi shtetërore jepet me qiradhënie personave fizikë dhe juridikë përmes thirrjes publike në periudhë për 10 vite, me mundësi vazhdimi. Vendimi për shpalljen e tenderit publik për dhënie me qira të kullotave në pronësi shtetërore të nxirret nga këshilli bashkiak ose të qytetit, në të cilën toka gjendet, pastaj duhet të merret mendimi nga rajoni dhe pëlqimin nga Ministria e Bujqësisë.

E drejta e personave të huaj për të qenë pronarë të tokës bujqësore

Në Republikën e Kroacisë, personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të jenë pronar të tokës bujqësore, por vetëm nëse me një marrëveshje shtetërore ndërkombëtare ose rregullore të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe Ligji për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RS Nr.112/15 dhe plotësim Ndryshimi i Ligjit për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RS Nr.80/2017.

Shembulli i Republikës së Shqipërisë

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore

1. Ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Propozimi për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit në hapësirat e tokës bujqësore bëhet në bazë të studimeve rajonale dhe masterplaneve, vetëm kur është vërtetuar dhe argumentuar:

a) Mungesa e plotë e sipërfaqeve të tjera fizike me tokë urbane të lirë, brenda vijave kufizuese të ndërtimit;

b) Mungesa e sipërfaqeve me tokë urbane, që mund të ripërdoret nëpërmjet prishjes së ndërtimeve të vjetra dhe kryerjes së ndërtimeve të reja, në përputhje me rregullat dhe normat urbanistike;

c) Mungesa e tokave të tjera të pafrytshme ose me vlera më të ulëta pjellorie natyrore, sipas bonitetit.

Argumentimi për këto raste përgatitet nga organi i ngarkuar me ligj për hartimin dhe mbrojtjen e studimit.

3. Strukturat e pushtetit vendor, të ngarkuara për mbrojtjen e tokës bujqësore në çdo rast, kur nuk janë dakord për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit në hapësirat e tokës bujqësore, i paraqesin ankesë organeve të ngarkuara me ligj.

Bazuar në ligjin aktual “Për mbrojtjen e tokës bujqësore, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ që përcaktonte rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore, në mbrojtje të tokës bujqësore, që miratohen në Këshillin Kombëtar të Territorit.

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

Bazuar në plotësim ndryshimin e Ligjit Nr.9244, date 17.6.2004 Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin nr. 69/2013, datë 14.02.2013:

“Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral”.

Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shoqërore në Republikën e Shqipërisë

Në Republikën e Shqipërisë - Privatizimi i tokës bujqësore është realizuar në bazë të Ligjit Nr. 7501, Për Tokën, datë 19.7.1991. Toka Bujqësore në pronësi shtetërore menaxhohet në harmoni me Ligjin Nr.8318 datë 1.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore pyjore, të livadheve dhe kullosave që janë pasuri shtetërore”.

VKM nr. 460, datë 22.5.2013, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”.

Ligji Nr.9693, datë 19.3.2007 Për Fondin Kullosor dhe Ligji Nr. 49/2016 për disa Ndryshime dhe Shtesa të Ligjit Nr. “Për Fondin Kullosor ”

Qiradhënia e kullotave në pronësi shtetërore

Përdorimi për kullotje

(shtuar pika 3/1, ndryshuar pika 6, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

1. Kullotat dhe livadhet shtetërore jepen në përdorim për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit, përkundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Për përdorim të përkohshëm kullosor, ato u jepen personave fizik e juridik për një periudhë kohore deri në 3 vjet. Kur personi fizik ose juridik synon të bëjë investime për përmirësimin e kullotës apo të infrastrukturës së saj, sipas një plani mbarështimi të miratuar nga drejtoria që mbulon kullotat, marrja në përdorim mund të zgjatet deri në 10 vjet, me kusht që investimet e planifikuara të realizohen.

Pronësia e kullotave shtetërore

Bashkitë janë pronarë të kullotave shtetërore që gjenden brenda territorit administrativ të tyre.

Shembulli i Republikës së Maqedonisë

Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shoqërore në Republikën e Maqedonisë

Në Republikën e Maqedonisë -Toka Bujqësore në pronësi shoqërore nuk është subjekt i privatizimit. Toka bujqësore menaxhohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në harmoni me Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RM Nr. 39/2014.

Toka shtetërore nuk mund të jetë subjekt i privatizimit, por ajo mund të menaxhohet si vijon: E dhënë me koncesion dhe me qira për persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj për një periudhë në varësi të prodhimtarisë që planifikohet të zhvillohet: për përdhë të shkurtë (5 vjeçare) dhe në baza afatgjatë (nga 5 deri në 40 vjet) me shpalljen publike. Përndryshe, toka bujqësore në pronësi të shtetit mund të jepet pa pagesë për kategoritë e grupeve shoqërore të cënueshme siç janë: bujq pa tokë, persona të papunë, shfrytëzuesve të ndihmës sociale, të papunë nga kompanitë e falimentuara dhe grupeve të ngjashme. Procedura e koncesionit realizohet nëpërmjet shpalljes publike me ankand nga ana e komisionit në bazë të vendimit të qeverisë dhe organizohet dhe mbikqyret nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të Republikës së Maqedonisë.

Shembulli i Republikës së Sërbisë

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore.

Bazuar në Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RS Nr.112/15 dhe plotësim Ndryshimi i Ligjit për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RS Nr.80/2017:

Qëllimi i shfrytëzimit të tokës bujqësore, Neni 15 Toka Bujqësore shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera, vetëm në raste dhe kushte të përcaktuara me këtë ligj.

Pëlqimi për ndërrim të destinimit të tokës së punueshme bujqësore Neni 24

Kërkesën për ndërrim të destinimit të tokës së punueshme bujqësore investitori ia paraqet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ligji për Planifikim dhe Ndërtim ("Gazeta zyrtare e RS Nr "145/2014 dhe

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore dhe pyjore në tokë ndërtimore

Neni 88

Kur me dokumentet e planifikimit ndërrohet destinimi i shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe pyjore në tokë ndërtimore, organi përgjegjës për miratimin e dokumentit të planifikimit është i obliguar që në afat prej 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij dokumenti, të dorëzojë tek organi përgjegjës për gjeodezi dhe kadastrë dokumentin e planifikimit, i cili përmban përshkrimin e parcelave kadastrale, të cilave iu ka ndryshuar ndërrimi i destinimit ose përshkrimi i kufirit të dokumentet e planifikimit dhe listën e parcelave kadastrale me përshkrimin përkatës grafik të saj.

Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shoqërore në Republikën e Serbisë

Toka Bujqësore nuk është subjekt i privatizimit. Toka bujqësore menaxhohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit në harmoni me Ligjin për Tokën Bujqësore "Gazeta zyrtare e RS Nr.112/15 dhe plotësim Ndryshimi i Ligjit për Tokën Bujqësore "Gazeta zyrtare e RS Nr.80/2017

Me ndryshimet fundit Ligjit për Tokën Bujqësore "Gazeta zyrtare e RS Nr.112/15 toka shtetërore mund të jetë subjekt i privatizimit me përjashtim kur ekonomitë bujqësore kanë deri në 30 ha, të tokës të punueshme do të mundësohet që të blejnë deri 20 ha të tokës bujqësore në pronësi shtetërore me afat pagesë prej 10 viteve. Toka bujqësore shtetërore mund të menaxhohet si vijon : i dhënë pa pagesë nëpërmjet shpalljes publike dhe me ankand i dhënë me qira për persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj për një periudhë në varësi të prodhimtarisë që planifikohet të zhvillohet: për periudhë të shkurtë (5 vjeçare)dhe në baza afatmesëm (nga 5 deri në 20 vjet) dhe me periudhë afatgjatë prej 30 viteve.

E drejta e personave të huaj për të qenë pronarë të tokës bujqësore

Në Republikën e Serbisë, pronar i tokës bujqësore nuk mund të jetë personi i huaj fizik dhe juridik, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre Anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Serbisë nga ana tjetër. Ligji për Tokën Bujqësore "Gazeta

zyrtare e RS Nr.80/2017 dhe plotësim Ndryshimi i Ligjit për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RS Nr.95/2018.

Shembulli i Republikës Federale të Bosnje e Hercegovinës

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore

Pëlqim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në Republikën Federale të Bosnje e Hercegovinës, bazuar në Ligjin për Tokën Bujqësore Nr. NR. 01-02-351/“Gazeta zyrtare e RFBH 52/09.

Ministria e Federatës së Bosnje e Hercegovinës jep pëlqimin për rregullimin hapësinor të kantoneve – Plani Hapësinor i Kantonit. Plani hapësinor i kantonit nuk mund të zbatohet nëse nuk është marrë pëlqimi nga paragrafi 1 i këtij neni.

Kuvendi i Kantonit miraton planet e zonimit për njësi më të vogla hapësinore brenda një kantoni (komunës, veçanërisht të zonës, qytete, fshatra).

Shfrytëzimi i kullotave në pronësi shoqërore

Kullota në pronësi shtetërore në territorin e Federatës së B&H administrohen nga Kantonet.

Ministria e Kantoneve miraton programin e shfrytëzimit të kullotave për çdo vit kalendarik.

Në Republikën Federale të Bosnje e Hercegovinës, toka bujqësore shtetërore nuk është subjekt i privatizimit. Toka bujqësore menaxhohet nga Ministria Federale për Bujqësi, Ujëra dhe Pylltari në harmoni me Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RFBH 52/09.

Toka shtetërore nuk mund të jetë subjekt i privatizimit, por ajo mund të menaxhohet si vijon: I dhënë me koncesion dhe me qira për persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj për një periudhë në varësi të prodhimtarisë që planifikohet të zhvillohet për përdhë të shkurtë (10 vjeçare) në baza afatmesëm (nga 10 deri në 20 vjet) dhe afatgjatë (25-50vjet).

E drejta e personave të huaj për të qenë pronarë të tokës bujqësore

Në Republikën Federale të Bosnje e Hercegovinës, personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të jenë pronar të tokës bujqësore vetëm nëse me një marrëveshje shtetërore ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe neni 7 i Ligjit për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RFBH 52/09.

Shembulli i Republikës së Sllovenisë

Praktikat e administrimit, privatizimit dhe menaxhimit të tokës bujqësore në pronësi shtetërore në Republikën e Sllovenisë

Në Republikën e Sllovenisë -Toka Bujqësore shtetërore nuk është subjekt i privatizimit toka bujqësore administrohet dhe menaxhohet nga Fondi Kombëtar i tokës bujqësore dhe fondi i pyjeve të Republikës së Sllovenisë, fondi i tokës bujqësore në pronësi shtetërore menaxhohet nga Departamenti për Bujqësi. Kjo përfshinë dhënien e tokës bujqësore në pronësi shtetërore me qira bazuar në tenderët publikë, lidhjen e kontratave të qirasë dhe monitorimin e tyre. Kjo është në harmoni me Ligjin për fondin e tokës dhe fondin e Pyjeve, Gazeta Zyrtare RS nr. 19/2010.

Shembulli i Republikës së Malit të Zi

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore

Në Republikën e Malit të Zi , ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore.

Bazuar në Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RMZ Nr.. 15/92 nga 10.04.1992, 59/92 nga 22.12.1992, 27/94 nga 29.07.1994, 73/10 nga 10.12.2010, 32/11 nga 01.07.2011)

Shfrytëzimi i Tokës Bujqësore për qëllime jo bujqësore

Toka bujqësore mund të shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore për ndërrim të përhershëm ose të përkohshëm në kushtet dhe mënyrën e paraparë me këtë ligj. Ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore mund të bëhet vetëm kur me Planin Urbanistik, përkatësisht me Planin Zhvillimor është paraparë ndërrimi i destinimit

Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shtetërore në Republikën e Malit të Zi

Në bazë të Ligjit mbi Pronën Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 21/09), Neni 5 i Rregullores mbi Shitjen dhe Qiradhënien e e Pronës në Pronësi Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 44/10) Toka bujqësore në pronësi shtetërore jepet me qira personave vendas dhe të huaj për një periudhë në varësi të prodhimtarisë që planifikohet të zhvillohet, për periudhë të shkurtër (1 vjeçare) në baza afatmesëm (nga 10 deri në 20 vjet) dhe afatgjatë (20-30vjet).

Shfrytëzimi i kullotave në pronësi shoqërore

Bazuar ne Ligjin për Tokën Bujqësore "**Gazeta zyrtare e RMZ** Nr.. 15/92 nga 10.04.1992, 59/92 nga 22.12.1992, 27/94 nga 29.07.1994, 73/10 nga 10.12.2010, 32/11 nga 01.07.2011).

Qeveri e Malit të Zi ,përcakton kushtet dhe procedurat për dhënien e kullotave ne pronësi shoqërore ne shfrytëzim

Praktikat e vendeve të tjera të cilat janë bashkuar BE-së, që personat e huaj fizik dhe juridike të jene pronare të tokës bujqesore

Vendet të cilat janë bërë anëtare të BE-së nga viti 2004 e deri më tani:

Hungaria: Deri ne vitin 2011 Personat e huaj fizik dhe juridike nuk mund të jenë pronarë të tokës bujqësore. Në vitin 2010 nga autoritetet zyrtare i është bërë një kërkesë Brukselit edhe për tri vite ndalesë me çka është aprovuar .

Në fillim të vitit 2012 Hungaria me amandamente kushtetuese ua ka ndaluar personave fizik dhe juridik të jenë pronarë pronarë të tokës bujqësore.

Polonia: Ka kërkuar nga Brukseli 18 vite ndalesë që personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të jenë pronarë të tokës bujqësore, ndërsa ju është aprovuar 12 vite

Republika e Çekisë , Sllovakisë , Bullgaria , Estonia, Lituania dhe Latvija ka kërkuar nga Brukseli 10 vite, Rumania ka kërkuar 15 vite ndalesë që personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të jenë pronarë të tokës bujqësore, ndërsa ju është aprovuar 7 vite. Kroacia ka kërkuar 12 vite ju ka aprovuar 7 vite . Sllovenia dhe Çipro nuk kanë kërkuar kushte dhe periudhë të ndalesë, por brenda 7 viteve nga hyrja në BE mund të aktivizojnë ndalesën që personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të jenë pronarë të tokës bujqësore.

Praktikat e Planifikimit Hapësinor në Vendet e Bashkimit Evropian – BE-së

Planifikimi Hapësinor në Vendet e **Bashkimit Evropian** është një sektor i decentralizuar. Nuk ka asnjë sistem të Planifikimit Hapësinor në Bashkimit Evropian asnjë autoritet të përbashkët, planifikimi në nivel të BE-së. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë kompetencë rregullatorë me planifikimin hapësinor në nivelin e Bashkimit Evropian, por politikat e tjera të BE-së, të cilat kanë kompetenca ligjore, instrumente dhe parime të përgjithshme ndikojnë dukshëm në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin përkatës. Në këtë kuptim planifikimi hapësinor është politikë e decentralizuar për secilën qeveri kombëtare dhe ndjek disa parime të përbashkëta të BE-së të planifikimit hapësinor.

Deri më sot, parimet kryesore dhe drejtimet kryesore mbi planifikimin hapësinor në Evropë përmbahen në dokumentet kryesore të BE-së për planifikimin hapësinor - Kartën Evropiane për Planifikim Hapësinor i miratuar në Konferencën e 6-të e Ministrave Evropianë përgjegjës për Planifikimin Rajonal të mbajtur në Torremolinos në maj të vitit 1983 dhe aprovuar nga Këshilli i Evropës dhe Perspektiva Evropiane për Planifikim Hapësinor (1999). Aprovuar në Këshillin Joformal të Ministrave përgjegjës për Planifikimin Hapësinor në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe anëtarë të Komisioni Evropian përgjegjës për Politikën Rajonale në Potsdam, Maj 1999. Botuar nga Komisioni Evropian.

Bazuar në Kartën Evropiane për Planifikim Hapësinor(1983) Planifikimit rajonal hapësinor duhet të jetë: demokratik, gjithëpërfshirës, funksional dhe i orientuar që të ketë një afat më të gjatë të veprimit.

Objektivat themelore të planifikimit hapësinor janë:

- Zhvillimi i balancuar socio-ekonomik të rajoneve;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës;
- Menaxhimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit;
- Shfrytëzimi racional i tokës.

Përveç parimeve të tjera njëri nga parimet bazë të Perspektivës Evropiane për Planifikim Hapësinor(ESDP) është ruajtja dhe menaxhimi i resurseve natyrore në fokus të veçantë toka bujqësore si resurse i pa ripërtëritshëm dhe është në harmoni me (Politika e kohezionit dhe vizioni i Evropës 2020), veçanërisht ndërtohet mbi këto parime. Në pamje të parë mund të duket se përafrimi i sektorit të planifikimit hapësinor në Kosovë me atë evropian, nuk përbën një detyrim për integrimin, por nuk është kështu. Politikën sektoriale evropiane kanë ndikime të thella, në mënyrë se si zhvillohet planifikimi i përdorimit të tokës në Kosovë.

Për shembull, direktiva e transportit, direktivat e mjedisit, direktiva e ujit, direktiva e nitrateve, direktiva shpendëve, direktiva biodiversitetit direktivat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tokës bujqësore dhe mjedisit etj.

Në Perspektivën Evropiane për Zhvillim Hapësinor rekomandohet krijimi i një modeli policentrit hapësinor të zhvillimit.

- Zhvillimi i një sistemi urban të balancuar dhe policentrik si dhe një marrëdhënie e re urbano-rurale;
- Sigurimi i barazisë së aksesit në infrastrukturë dhe njohuri;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, menaxhimi i kujdesshëm dhe mbrojtja e natyrës dhe e

trashëgimisë kulturore.

Parime të Planifikimit dhe Zhvillimit të Tokës

- a) Zhvillimi i qëndrueshëm, social, ekonomik dhe mjedisor: balanca e trekëndëshit të qëndrueshmërisë. Zhvillim i cili përmbush nevojat e së tashmes, pa kompromentuar mundësinë e gjeneratave të ardhshme, për të përmbushur nevojat e tyre.

Një ndër hapat kryesorë në planifikim do të jetë pikërisht përvetësimi i politikave të Perspektivës Europiane për Zhvillimin Hapësinor (ESDP), si dhe përshtatja ndaj ndikimeve mbi territor të Direktivave Sektoriale të BE-së dhe mund të shihet përputhshmëria me Strategjinë “Europë 2020” të Komisionit Evropian dhe me Politikën Rajonale dhe të Kohezionit të BE-së 2014-2020, nën ESDP.

Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës:

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqesore në tokë për qëllime jo bujqësore

Praktika e Republikës së Kroacisë, sipas së cilës Ministria e Bujqësisë jep mendim në propozim Strategjinë e Rregullimit Hapësinor të Shtetit, si dhe Programin e Rregullimit Hapësinor të Shtetit në Planet Zhvillimore të Regjioneve dhe Planet Zhvillimore me karakteristika të veçanta, si dhe Ministria jep pëlqim në draftin përfundimtar të propozimit të Planit Hapësinor të komunave.

Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shoqërore

Praktika e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas së cilës Toka Bujqësore në pronësi shoqërore nuk është subjekt i privatizimit. Toka bujqësore menaxhohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në harmoni me Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RM Nr. 39/2014”.

Toka shtetërore nuk mund të jetë subjekt i privatizimit, por ajo mund të menaxhohet si vijon: i dhënë me koncesion dhe me qira për persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj për një periudhë në varësi të prodhimtarisë që planifikohet të zhvillohet: për periudhë të shkurtër (5 vjeçare) dhe në baza afatgjate (nga 5 deri në 40 vjet) me Shpallje publike. Përndryshe, toka bujqësore në pronësi të shtetit mund të jepet pa pagesë për Kategoritë e grupeve shoqërore të cënueshme siç janë: bujq pa tokë, persona të papunë, shfrytëzuesve të ndihmës sociale, të papunë nga kompanitë e falimentuara, si dhe grupeve të ngjashme. Procedura e koncesionit realizohet nëpërmjet shpalljes publike me ankand nga ana e komisionit në bazë të vendimit të qeverisë dhe të organizohet dhe

mbikëqyret nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shfrytëzimi i kullotave në pronësi shoqërore

Praktika e Republikës së Malit të Zi, e cila në bazë të Ligjit për Tokën Bujqësore parasheh që Qeveria të përcaktojë kushtet dhe procedurat për dhënien e kullotave në pronësi shoqërore në shfrytëzim.

E drejta e personave të huaj për të qenë pronarë të tokës bujqësore

Praktika e Republikës së Kroacisë, Ligji për Tokën Bujqësore sipas, të cilit personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të jenë pronarë të tokës bujqësore, përveç nëse me marrëveshje shtetërore ndërkombëtare ose rregullore të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i përgjithshëm i politikës – Shfrytëzimi i tokës bujqësore për prodhimtari bujqësore për të siguruar prosperitet ekonomik të vendit	
Objektivi strategjik: Menaxhimi i tokës bujqësore si një resurs natyror dhe e mirë e përgjithshme duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e saj për prodhimtarinë bujqësore për të siguruar prosperitet ekonomik të vendit. Objektivat specifike: - Përmirësimi i menaxhimit të drejtë i dhe të qëndrueshëm të tokave bujqësore dhe kullotave në pronësi shoqërore; - Administrimi dhe Menaxhimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i tokave bujqësore që menaxhohen nga Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) në Pejë; - Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, ndotja, erozioni, degradimi, etj; - Qiradhënia e Tokës Bujqësore;	- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 2.10. Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural 2.10.3 Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokës bujqësore, pyjeve dhe ujit për ujë). Plani Strategjik dhe Operacional Qëllimi Strategjik 2 –Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokave bujqësore, pyjeve dhe ujit për ujë); Objektivi operacional 2.1 – Përmirësimi i politikave për menaxhimin dhe ruajtjen e tokës bujqësore; Aktiviteti 2.1.1 – Hartimi i Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 Shtylla I-Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit; Masa 13- Forcimi i shtetit të të drejtave pronësore; Aktiviteti 2- Promovimi i tregut të tokës që mundëson rritje ekonomike, duke përfshirë lehtësimin e konsolidimit të tokave bujqësore, si dhe hartimin dhe miratimin e planeve zhvillimore komunale dhe hartave zonale; Shtylla II – Industritë konkurruese, Masa 20 – Rregullimi i tokave bujqësore, Aktiviteti 1 – Përgatitja dhe financimi i

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

	Projektit të Rregullimit të Tokës dhe Integrimit në Projektet e Zhvillimit Rural; Aktiviteti 2 – Ndërmarrja e reformave strukturore (me theks në masa ligjore dhe institucionale) me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore; Aktiviteti 3 – Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësor, si dhe do të realizohet projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS); Aktiviteti 4 – Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal- qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër; Programi për Reforma në Ekonomi 2021-2023 Masa e reformës #3: Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë 2. Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore me fokus në produkte me vlerë të shtuar; (MBPZhR) Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2021 (PKZMSA) 3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural; 3.11.3 Masat zbatuese- Korniza e Politikave- Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore.
Objektivat specifike Opsioni 2:	Të hartuara për nevojat e këtij KD

• Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit • Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane • Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e tokës bujqësore	
Objektivat specifike Opsioni 3: • Avancimi i kornizës legislative dhe rregullative për tokën bujqësore • Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit • Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, ndotja, erozioni, degradimi • Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e tokës bujqësore • Promovimi i tregut të tokës bujqësore	Të hartuara për nevojat e këtij KD

Kapitulli 3: Opsionet

3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni i parë është që të vazhdohet me zbatimin e politikës dhe kornizës ligjore aktuale për menaxhimin e tokave bujqësore. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdonte me zbatimin e Ligjit për Tokën Bujqësore. Por, zbatimi i këtij ligji në praktikë ka qenë sfidues për MBPZhR-në, MMPHI-në dhe komunat. Me vazhdimin e opsionit pa ndryshime do të vazhdojnë edhe vështirësitë e paraqitura. Pra, do të vazhdojnë humbja, ndotja dhe degradimi i mëtutjeshëm i tokës bujqësore, do të vazhdojë dhe menaxhimi jo i drejtë dhe i qëndrueshëm i tokave bujqësore dhe kullotave në pronësi shoqërore, dhe tokave bujqësore që aktualisht menaxhohen nga Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) në Pejë. Mos-definimi i qartë i kompetencave në mes nivelit qendror dhe atij lokal, mungesa e mbikëqyrjes adekuate të zbatimit të Ligjit.

Për shkak të menaxhimit jo të drejtë dhe jo të qëndrueshëm të tokave bujqësore në pronësi shoqërore, toka bujqësore do të vazhdojë të shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore, fragmentimi i tokës në pronësi shoqërore e humb efektin për të qenë konkurrues për shkak të madhësisë së fermës që në ekonomi njihet si “Ekonomia e Shkallës” me qëllim të rritjes së madhësisë së fermës së tyre, rritjes së prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale në nivel të vendit, rritjes së aftësisë konkurruese të fermës, zvogëlimit të shkallës së importit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dhe përmirësimin e mirëqenjes së e popullatës që merret me veprimtari bujqësore-blegtorale dhe në përgjithësi gjendja e tokës bujqësore si resurs natyror dhe e mirë e përgjithshme do të përkeqësohet edhe më tepër.

3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje - Divizioni i Tokave Bujqësore në MBPZhR është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit për Toka Bujqësore përmes inspektorëve të tokave bujqësore apo organeve të autorizuara.

Aktualisht në kuadër të këtij divizioni nuk ka asnjë inspektor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore.

Në anën tjetër, nga përvoja e deritashme MMPHI i miraton Planet Zhvillimore Komunale pa marrjen e pëlqimit nga MBPZhR sipas Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore Neni 10 pika 3.

Për përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore Opsioni 2 parasheh të ndërmerren këto masa:

- Rritjen e buxhetit për aktivizimin e inspektorëve të tokës bujqësore në nivelin qendror;
- Koordinim me të mirë ndërinstitutional në mes të nivelit qendror dhe lokal (MBPZhR, MMPHI, MAPL, AKP, komunat) për harmonizimin e politikave në menaxhimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e tokës bujqësore;
- Në veçanti, përmirësimin e koordinimit me MMPHI-në dhe komunat rreth marrjes së pëlqimeve nga MBPZhR-ja për planet zhvillimore komunale;
- Trajnimet e stafit në nivelin lokal dhe qendror;
- Vetëdijësimin e popullatës përmes organizimit të kampanjes dhe sensibilizimit të institucioneve përgjegjëse.

3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument]

Ky opsion parasheh plotësim-ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, i cili do të eliminonte shkaqet dhe efektet e cekura të definimi të problemit:

Ky ligj do të adresonte çështjet që janë të parregulluara apo kanë zbrazëtira juridike. Përmes këtyre ndryshimeve do të rregullohet në mënyrë me precize:

- Menaxhimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i tokave bujqësore dhe kullotave në pronësi shoqërore; tokave bujqësore që aktualisht menaxhohen nga Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK);
- Marrja e pëlqimit për Planin Zhvillimor Komunal;
- Procedurat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore;
- Mënyrën e raportimit rreth ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore;
- Qiradhënien e tokave bujqësore dhe tokave të cilat janë të papunuara;
- Përmirësimin e menaxhimit të kullotave në pronësi publike;
- Rishikimi i tarifave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore;
- Definimi më i qartë i kompetencave të inspektorëve të tokave bujqësore.

Projektligji i ri do të përcaktojë:

- Menaxhimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i tokave bujqësore në pronësi shoqërore me qëllim që ato të jepen me qira për aktivitete bujqësore dhe krijimi i fondit të tokës bujqësore;
- Fondi i tokës bujqësore do të krijohet me ligj, do të administrohet dhe menaxhohet nga MBPZHR bazuar në ligjin për Tokën Bujqësore që do të shërbejë si instrument për mbështetje të konsolidimit të tokës;
- Ruajtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e pa autorizuara përmes dhënies së pëlqimeve nga MBPZHR dhe MMPHI për planet zhvillimore komunale, si dhe definimi më i qartë i afateve kohore për dhënien e pëlqimeve (afatet janë të përcaktuara me Ligjin Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 98 Afati për përfundimin e procedurës administrative);
- Angazhimin e inspektorëve për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe koordinimi me inspektorët e nivelit komunal për zbatimin e Ligjit të ri për Tokën Bujqësore;
- Përmirësimi i menaxhimit të kullotave në pronësi publike, të definohet qartë institucioni përgjegjës për menaxhimin e kullotave, të shikohet mundësia e menaxhimit përmes kompanive private; Institucioni përgjegjës për menaxhimin e kullotave do të jetë MBPZHR, përgjegjësit dhe kompetencat e këtij Institucioni do të

KONCEPT DOKUMENTI PËR TOKËN BUJQËSORE

përcaktohen me Ligjin për Tokën Bujqësore. Ky rekomandim ka dal edhe nga Raporti i Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mbrotje të Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor të vitit 2011;

- Definimi më i qartë i procedurave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është përgjegjësi e MBPZHR-ës dhe komunave, ndërsa afatet kohore për dhënien e pëlqimit apo refuzimit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Rishikimi i tarifave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore bazuar në Ligjin aktual është i njëjtë për tërë territorin e Republikës së Kosovës sipas klasifikimit kadastral të tokës bujqësore, rishikimi do të ketë fokus në çmimin e tregut të tokës bujqësore;
- Definimi më i qartë i kompetencave të inspektorëve të tokave bujqësore janë të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-029, për Inspektionin Bujqësor “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12 janar 2009”, Ligjin për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26. Në ndërkohë është hartuar draft Ligji për Inspektimet sponsorizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Qëllim i këtij Ligji është krijimi i kuadrit të nevojshëm ligjor për zbatimin e reformës së sistemit të inspektimeve në Republikën e Kosovës, përmes racionalizimit të numrit të organeve inspektuese në administratën shtetërore, sqarimin e kompetencave të tyre përkatëse, përmirësimin e koordinimit dhe unifikimin e procedurave dhe kërkesave për zhvillimin e inspektimeve nga organet inspektuese në administratën shtetërore dhe nivelin komunal;
- Përmes menaxhimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore favorizohen investimet strategjike jo vetëm në fushën e bujqësisë, por edhe në sektorët tjerë shembull burimet e energjisë alternative (era, uji, dielli);
- Menaxhimi i drejtë dhe i qëndrueshëm tokës bujqësore në pronësi shoqërore nga Institucioni i autorizuar do të jepet me qira përmes procedurave ligjore për investitorët që merren me veprimtari bujqësore, duke ndikuar në shtimin e bizneseve të reja dhe punësim;
- Të drejtën e personave fizikë dhe juridik të huaj për të qenë pronarë të tokës bujqësore në Republikën e Kosovës;
- Caktimi i sipërfaqes së parcelës së tokës bujqësore të punueshme, e cila nuk mund të fragmentohet nën sipërfaqen e përcaktuar (0.50 ha), përveq ngritjes së objekteve me rendesi të vecant;

Për një menaxhim më të mirë të kullotave në pronësi shoqërore duhet të kemi parasysh qartësimin e kompetencave të administrimit dhe menaxhimit në mes nivelit qendror dhe

komunal, duke përfshirë edhe sektorin privat (përfshirë personat fizikë e juridikë), kullotat jepen me qira për një periudhë kohore prej 3 vitesh, ndërsa kur personi fizik ose juridik synon të bëjë investime për përmirësimin e kullotës apo të infrastrukturës së saj, marrja me qira mund të zgjatet deri në 10 vite, me kusht që investimet e planifikuara të realizohen.

Për hartimin e një plani menaxhues të kullotave në pronësi shoqërore, kërkohen informacione si në vijim:

1. Tipi i kullotave

Klasifikimi i kullotave bazuar në sezonin e kullotjes (sipas lartësisë mbidetare dhe periudhës së përdorimit), e cila lidhet ngushtë me periudhën e vegetacionit.

2. Shkalla e mbulimit

Shkalla e mbulimit vlerësohet sipas mbulesës së bimëve barishtore në % kundrejt sipërfaqes totale të parcelës.

Llogaritet në përqindje në raport me sipërfaqen totale të mbuluar nga bimësia barishtore, sipërfaqet e zhveshura, shkëmbore, etj.

3. Përbërja e specieve

Përbërja e specieve përcaktohet prej grupeve kryesore (Graminace, Leguminoze, etj).

4. Llogaritja e lartësisë

Lartësia llogaritet për 3 tipet kryesore të mbulesës (bimë barishtore, drurë dhe shkurre).

5. Vlerësimi i koeficientit të përdorimit të kullotës

Vlerësimi i sasisë së barit të konsumuar nga kafshët gjatë periudhës së kullotës.

Në përdorimin e kullotës kërkohet të bëhet balancimi midis sasisë së barit që prodhohet dhe sasisë së barit që konsumohet.

6. Llogaritja e kapacitetit mbajtës të kullotës

Numri mesatar i kafshëve që kullosin gjatë një sezoni kullotjeje.

Kapaciteti i mbajtjes vjetore dhe afatgjate i kullotës na jep një indikacion mbi numrin e duhur të kafshëve nën një regjim të caktuar kullotjeje.

7. Vlerësimi i numrit të kafshëve në kullotë

Numri kafshëve përfaqëson numrin e llojeve specifike dhe klasave të kafshëve që kullosin ose që përdorin një njësi toke për një periudhë kohore specifike.

8. Gjendja e zjarreve në kullotë

Zjarri mund të jetë një rrezik kryesor për ekosistemet kullosore.

9. Mbulesa me gurë të lëvizshëm

Përkufizimi: Sipërfaqja e mbuluar nga gurët e lëvizshëm në tokë e shprehur në %.

Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të mirren parasysh gjatë hartimit të Ligjit të ri janë:

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore -

Praktika e Republikës së Kroacisë, sipas të cilës Ministria e Bujqësisë jep mendim në propozim Strategjinë e Rregullimit Hapësinor të Shtetit, si dhe Programin e Rregullimit Hapësinor të Shtetit, në Planet Zhvillimore të Regjioneve dhe Planet Zhvillimore me karakteristika të veçanta, si dhe Ministria jep pëlqim në draftin përfundimtar të propozimit të Planit Hapësinor të komunave.

Menaxhimi i tokës bujqësore në pronësi shoqërore -

Praktika e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas të cilës Toka Bujqësore në pronësi shoqërore nuk është subjekt i privatizimit. Toka bujqësore menaxhohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në harmoni me Ligjin për Tokën Bujqësore “Gazeta zyrtare e RM Nr. 39/2014”.

Toka shtetërore nuk mund të jetë subjekt i privatizimit, por ajo mund të menaxhohet si vijon: i dhënë me koncesion dhe me qira për persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj për një periudhë në varësi të prodhimitarisë që planifikohet të zhvillohet: për periudhë të shkurtër (5 vjeçare) dhe në baza afatgjate (nga 5 deri në 40 vjet) me Shpallje publike. Përndryshe, toka bujqësore në pronësi të shtetit mund të jepet pa pagesë për Kategoritë e grupeve shoqërore të cënueshme, siç janë: bujq pa tokë, persona të papunë, shfrytëzuesve të ndihmës sociale, të papunë nga kompanitë e falimentuara dhe grupeve të ngjashme. Procedura e koncesionit realizohet nëpërmjet shpalljes publike me ankand nga ana e komisionit në bazë të vendimit të qeverisë dhe të organizohet dhe mbikëqyret nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shfrytëzimi i kullotave në punësi shoqërore -

Praktika e Republikës së Malit të Zi e cila në bazë të Ligjit për tokën bujqësore parasheh që Qeveria të përcaktojë kushtet dhe procedurat për dhënien e kullotave në pronësi shoqërore në shfrytëzim.

E drejta e personave të huaj për të qenë pronarë të tokës bujqësore -

Praktika e Republikës së Kroacisë, Ligji për Tokën Bujqësore, sipas të cilit personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të jenë pronarë të tokës bujqësore, përveç nëse me marrëveshje shtetërore ndërkombëtare ose rregullore të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Bërja e biznesit (qasjen në financa për biznes) Tregtia (ndryshimi i flukseve aktuale të importit dhe eksportit) Investimet (investime në veprimtari të reja, investimet nga diaspora) Ndikimi në NVM Ndikimet ekonomike rajonale Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik
Ndikimet shoqërore	Kultura (ruajtja e trashëgimisë kulturore) Shëndeti dhe siguria publike (jeta e njerëzve dhe cilësia e ushqimit, cilësia e tokës)
Ndikimet mjedisore	Cilësia e ujit (cilësia e ujërave nëntokësore) Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës Erozioni i tokës Ndryshim në shfrytëzimin e tokës Mirëqenia e kafshëve (shëndeti i kafshëve, ushqimi i kafshëve)
Ndikimet në të drejtat themelore	Administrimi i mirë (mënyra e marrjeve të vendimeve nga administrata)
Ndikimi gjinor	Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqërore që sigurojnë të drejta të barabarta
Ndikimet e barazisë sociale	
Ndikimet tek të rinjtë	
Ndikimet në ngarkesën administrative	
Ndikimi i NMV-ve	

Ndikimet ekonomike

Bërja e biznesit

Me vendosje të kësaj politike investitorëve do t'iu mundësohet qasja në thithjen (të largohet) e kredive në institucionet financiare për biznes, sepse do të rregullohet çështja e planifikimit të përdorimit të tokës bujqësore dhe qiradhënies së saj. Menaxhimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i tokave bujqësore, kullotave në pronësi shoqërore dhe tokave bujqësore që aktualisht menaxhohen nga IBK, do të ndikojë në rritjen e të ardhurave për bizneset që kanë veprimtari bujqësore, sepse tokat bujqësore do të ipen me qira ose koncesion e që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të vendit rritjen e produktivitetit bujqësor dhe zvogëlimin e importit të produkteve bujqësore.

Korniza ligjore do t'iu mundësoj bizneseve të reja të kenë politika të mirëfillta në aspektin e përdorimit të tokës bujqësore, qiradhënies dhe menaxhimit të tokës bujqësore.

Tregtia

Me vendosjen e këtyre politikave synohet përmirësimi i kushteve për prodhimtari bujqësore përmes menaxhimit më të mirë të tokës bujqësore, qiradhënia e tokës bujqësore, rritjen e madhësisë së fermës përmes zhvillimit të tregut të tokës.

Me këtë politikë një pjesë e produkteve bujqësore do të jenë konkurruese në treg për nga aspekti i cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

Investime

Mendohet të krijohet klimë e re e investimeve në sektorin e bujqësisë duke marrë parasysh menaxhimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore dhe kullotave në pronësi shoqërore, si dhe tokave bujqësore që aktualisht menaxhohen nga IBK, mbrojtjen dhe qiradhënien e tokës bujqësore.

Me menaxhimin e qëndrueshëm, mbrojtjen dhe qiradhënien e tokës bujqësore do të ketë lehtësira dhe do të rriten investime nga diaspora.

Ndikimi në NVM

Ofrimi i këshillave konsultuese të specializuara dhe asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe organizative të NVM-ve GLV-ve, etj; trajnimet në planifikim, marketing, klasifikim dhe paketim të produkteve.

Ndikimet ekonomike rajonale

Do të ndikohet Sektori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, por jo i koncentruar në ndonjë rajon të caktuar.

Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik

Rritja e investimeve në Sektorin e Bujqësisë ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ndikimet shoqërore

Kultura

Me përkrahjen dhe promovimin e prodhimeve tradicionale të përpunuara, si: reçeli, ëmbëlsirat, turshitë, verërat, çajërat, produktet e mishit e të qumështit, etj.

Shëndeti dhe siguria publike

Mbështetja institucionale e iniciativave për projekte dhe programe që kanë të bëjnë me shfrytëzimin racional të resurseve bujqësore, pyjore, blegtorale e ambientale:

- fermerët apo grupet e organizuara që kanë vizion edhe ruajtjen e pasurive për gjeneratat që vijnë,
- duke kultivuar prodhime organike, bimë mjekuese dhe aromatike,
- prodhuesit dhe përpunuesit që plotësojnë standardet HACCAP,
- Inspektimin dhe certifikimin e bizneseve që respektojnë standardet për paketimin, transportin dhe deponimin e produkteve,

Me këtë politikë synohet që të përmirësohet menaxhimi më i mirë i tokës bujqësore, duke ndikuar në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit me përdorimin e kontrolluar të agroinputeve bujqësore.

Cilësia e ujit

Politika e re do të mundësoj përmirësimin e cilësisë së ujrave nëntokësore përmes ruajtjes dhe mbrojtjes së tokës bujqësore dhe përdorimit të agroinputeve bazuar në standardet evropiane.

Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës

Me këtë politikë synohet që të ketë përmirësim të cilësisë së tokës (dheut) në lidhje me mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndotja, ndërmarrja e masave melorative dhe agroteknike dhe përdorimi i kontrolluar i agroinputeve bujqësore.

Erozioni i tokës

Synohet të përmirësohet politikat dhe veprimet në ndërmarrjen e masave në mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni.

Ndryshim në shfrytëzimin e tokës

Ndryshimi i shfrytëzimit të tokës bujqësore - pyjore në tokë për qëllime jobujqësore-pyjore do të bëhet bazuar dokumentet e planifikimit hapësiror dhe organet e autorizuar ligjore.

Mirëqenia e kafshëve

Me përmirësimin e menaxhimit të kullotave në pronësi shoqërore dhe kontrollimi i lëvizjeve nomade të kafshëve do të ndikohet në përmirësimin e shëndetit të kafshëve;

Përmes përmirësimit të menaxhimit të kullotave në pronësi shoqërore, përdorimit të kontrolluar të agroinputeve bujqësore, si dhe mbrotjen e tokës bujqësore nga ndotja.

Ndikimi në të drejtat themelore

Administrimi i mirë

Me përmirësimin e kësaj politike procedurat administrative do të jenë më transparente, do të eliminohen procedurat e tepërta byrokratike dhe të përcaktohen afatet procedurale për zgjidhjen e lëndëve.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Ndikimi i të dhënave në hartimin e Koncept Dokumentit (mbledhja e të dhënave)

Gjatë hartimit të Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore jemi shërbyer me të dhëna, të cilat burim të informacionit kanë Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, Regjistrimin e fundit të Bujqësisë të vitit 2015 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Privatizimit të Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, komunat, etj.

Meqenëse sigurimi i të dhënave nga fusha e bujqësisë realizohet me vështirësi, veçanërisht si anketa ku përfshihen brenda vitit rreth 4 deri 5 % të numrit të përgjithshëm të ekonomive familjare të Kosovës, ndërsa regjistrimi i bujqësisë realizohet çdo 10 vite, mund të themi se këto të dhëna nuk i plotësojnë kërkesat për analiza më të detajuara dhe të sakta. Të dhënat ekzistuese nuk mund të përfaqësojnë me këtë përqindje të ulët gjendjen reale të ekonomive familjare bujqësore.

Agjencia e Statistikave të Kosovës është gjeneruesi më i autorizuar i të dhënave, ku çdo vit realizon anketën për ekonomi familjare bujqësore me metodën e zgjedhjes së rastit duke përfshirë rreth 4-6% e ekonomive familjare bujqësore ekzistuese. Ndërsa, çdo 10 vite parashihet të organizohet regjistrimi i bujqësisë.

Të dhënat e raportit të Regjistrimit të Bujqësisë për shfrytëzimin e tokës që realizohen çdo 10 vite përfshijnë regjistrimin e të gjitha variablave të shfrytëzimit të tokës së ekonomive familjare, si: sipërfaqet, struktura e kulturave bujqësore, rendimentet, masat agroteknike siç është ujitja dhe trajtimi me plehera e pesticide, etj. Ndërsa, të dhënat e anketave edhe pse realizohen çdo vit, nga përqindja e ulët e përfshirjes së ekonomive bujqësore në anketë nuk mund të themi që janë reprezentative.

Regjistrimi i Bujqësisë që realizohet në bashkëpunim të MBPZHR-së dhe ASK-së, mbetet burimi më i besueshëm i të dhënave të shfrytëzimit të tokës.

Ndërsa, Agjencia e Kadastrale e Kosovës posedon të dhëna hapësinore me kufijë administrativ të komunave, zonave kadastrale dhe deri në nivel të parcelave.

Gjithashtu, në MBPZHR aplikacioni që përfshinë Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS) dhe Regjistri i Fermave realizuar me programin GIS, ka arritur të krijoj një bazë të qëndrueshme me të dhëna hapësinore për përdorimin e tokës e që është në funksion të skemave mbështetëse për grante dhe pagesa direkte për fermerët.

Vlenë të përmendet se MBPZHR-ja ka realizuar edhe hartën digjitale pedologjike (e dheut), ku përfshihen tipet e tokës me të dhëna strukturës së tokës, thellësisë, drenazhit, etj.

Përmes mbështetjes së disa projekteve nga Komisioni Evropian në MBPZHR është krijuar një Gjeobazë, me të dhëna hapësinore të prezantuara edhe në harta, ku përfshihen: harta e Përshatshmërisë së shfrytëzimit të tokës, Plani i veprimit në mjedis rural, Plani për zonimin e ndërtimit (kufizimet e pjesërishme dhe të plota) ndjeshmëria e ujërave nëntokësorë, ndjeshmëria e tokës në mjedis, ndjeshmëria e tokës në erozion, intensiteti i shfrytëzimit të tokës, përshatshmëria e integruar e tokës, plani për shfrytëzimin optimal të tokës dhe Corine land cover (mbulesa e tokës), etj.

Sipërfaqet bujqësore dhe pyjore që u përkasin lartësive mbi 700 m mbi nivelin e detit dhe me pjerrtësi të terrenit mbi 10 %, janë të kategorizuara si Zona më pak të favorizuara gjithashtu të paraqitura në harta.

